



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr. 9647 Prot

Shkodër, më 22.09.2026

Lënda: Kërkesë për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt - vendimin "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr. 1, datë 22.01.2016 "Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër" të ndryshuar "

Duke ju uruar punë të mbarë !

KRYETAR

Benet BECI

Me vendim delegim

Z./KRYETAR

Alban PRISKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. _____ prot.

Shkodër, më ____ . ____ .2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2026




“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKB NR 1, DATË 22.01.2016 “PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ____ / ____ 2026, me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9 pika 1.3, nenit 35 pika 1, nenit 54 shkronja (f) të ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “ të ndryshuar; Ligjit nr 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Ligjit nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; ligji nr 10352 datë 18.11. 20210 “Për Artin dhe kulturen në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ligjit 107 date 31.7.2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimet dhe shtesat në VKB-në nr 1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në bashkinë Shkodër” të ndryshuar, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Zv/Kryetar 	Zv/Kryetar 
Zv/Kryetar 	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore 
Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit PANDI LACO 	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit 
Drejtoria e Sportit 	Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar 
Drejtoria e Kulturës 	Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse 
Drejtoria e Shërbimeve Sociale 	Drejtoria Juridike 
Drejtoria e Arsimit 	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit 
Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrushëm Ekonomik 	IMT 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2026

RELACION

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKB NR 1, DATË 22.01.2016 “PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR ”, TË NDRYSHUAR

Bashkia Shkodër ka në zbatim VKB nr. 1, datë 22.01.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar.

Gjatë vitit 2022-2023 kanë ndodhur një sërë ndryshimesh në disa akte ligjore dhe nënligjore për disa fusha që janë në kompetencë dhe funksione të njëjësive të qeverisjes Vendore. Kështu drejtoritë përkatëse në Bashkinë Shkodër kanë vlerësuar sipas fushave të kompetecës këto ndryshime dhe kanë vlerësuar domosdoshmërinë e përfshijes në sistemin e taksave dhe tarifave vendore. Gjithashtu me iniciativat e ndryshme të ndërmarra nga Bashkia Shkodër si pasojë e nevojës së menaxhimit të territorit apo të shërbimeve publike dhe zbatimit të rregulloreve të miratuara nga Këshilli Bashkiak, propozohen ndryshime dhe shtesa sa i përket taksave dhe tarifave vendore.

Referuar sa më sipër në zbatim të bazës ligjore: në mbështetje të nenit 9 pika 1.3, nenit 35 pika 1, nenit 54 shkronja (f) të ligjit nr.139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore“ i ndryshuar; nenit 11 të ligjit nr 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” i ndryshuar; Ligjit nr 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “ të ndryshuar; Ligjin Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar; Ligjit nr 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar; Ligjit nr 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar, ligjit 107 date 31.7.20214 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar VKB në vite për shtesa dhe ndryshime në paketën fiskale, si dhe relacionit të administratës së bashkisë Shkodër, propozohen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijojnë.

Ndryshimet ligjore për Ligjin mbi të Ardhurat të miratura me Ligjin Nr. 29/2023 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT” i ndryshuar, parashikojne që për:

- i. individët tregtarë;
- ii. të vetëpunësuarit, si dhe;
- iii. entitetet:

me të ardhura bruto deri 14 milionë lekë në vit, norma e tatimit mbi të ardhurat 0% do të aplikohet deri më **31 dhjetor 2029**.

Bashkia Shkodër i ka kategorizuar bizneset në bazë të përgjegjësisë tatimore për efekt të përlllogaritjes së tarifave vendore (tarifë pastrimi, tarifë ndricimi, tarifë gjelberimi) ne Biznes I Vogël (Tatim I Thjeshtuar mbi Fitimin) dhe Biznes I Madh (Tatim mbi Fitimin) referuar ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, I ndryshuar.

Ndryshimet ligjore për Ligjin mbi të Ardhurat të miratura me Ligjin Nr. 29/2023 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT” i ndryshuar cili ka shfuqizuar ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 si pasojë ka sjellë dhe shfuqizimin e kategorizimit të bizneseve: biznes i vogël dhe biznes i madh. Për efekt të llogaritjes së tarifave vendore duhet bërë rikatëgorizimi i ri.

Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore për të qënë në të njëjten linje ka vendosur që kategorizimi i biznese të bëhet mbi bazën e qarkullimit vjetor pavarësisht formës juridike Person Fizik apo Entitet ku përjashtohen kategoria Ambulant, Institucione Shtetërore dhe OJF.

- a) Kategoria e parë deri ne 8,000,000 leke xhiro në vit
- b) Kategoria e dytë mbi 8,000,000 leke xhiro në vit

Sqarime:

- a. Xhiro vjetore bazohet mbi qarkullimin total të subjektit, për një vit fiskal.
- b. Kategorizimi i subjekteve për efekt tarifimi do të bëhet në bazë të xhiros vjetore të vitit paraardhës, duke përfshirë xhiron totale të të gjitha adresave pavarësisht vendndodhjes, marrë nga Drejtoria e Tatimeve ose bazuar në vërtetimin e xhiros që e ka detyrim për të paraqitur vetë subjekti, kur i kërkohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- c. Subjektet që regjistrohen për herë të parë gjatë vitit korrent do të kategorizohen në kategorinë deri në 8 milion lekë xhiro në vit, për efekt të vlerësimit dhe pagesës së detyrimeve vendore.
- d. Subjektet që kalojnë në statusin “aktiv” pas një periudhe të gjatë pasiviteti (me status “i pezulluar”) më shumë se një viti fiskal, do të vlerësohen në kategorinë deri në 8 milion lekë xhiro në vit, për efekt të pagesës së detyrimeve vendore.
- e. Subjektet që kërkojnë çrregjistrim gjatë vitit fiskal duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vërtetim xhiro të vitit korrent, për efekt të vlerësimit dhe pagesës së detyrimeve vendore.

- f. Subjektet që hapin adresa sekondare në territorin e Bashkisë Shkodër duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vërtetim xhiro të vitit paraardhës, pët të gjitha adresat që disponojnë të marra së bashku.
- g. Për të gjithë subjektet që kanë ndryshim pragu të xhiros vjetore gjatë vitit 2026 bëhet rivlerësim i kategorizimit në vitin 2027, për efekt të vitit ushtrimor paraardhës. Kjo procedurë do të ndiqet në vijimësi për të gjitha periudhat pasardhëse ushtrimore.
- h. Subjektet që i janë nënshtruar rivlerësimit dhe janë me tepricë kreditore, vlera e paguar më tepër do të mbartet për vitet pasardhëse.
- i. Subjektet që i janë nënshtruar rivlerësimit dhe janë me tepricë debitore, vlera e detyrimit ka afat pagese 30 Qershor të vitit korrent.

Propozime për lehtësira Fiskale

Përfashtim i tarifave lokale për subjektet dhe sipërmarrjet e drejtuara nga gratë kryefamiljare me fëmijë nën 22 vjeç.

1. Baza kushtetuese dhe parimet e mbrojtjes sociale dhe ekonomike

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton:

- **Neni 52** – Mbrojtja sociale për personat në nevojë.
- **Neni 54** – Mbrojtja e veçantë për fëmijët dhe të rinjtë.
- **Neni 59** – Objektivat sociale të shtetit, përfshirë:
 - punësimin,
 - zhvillimin ekonomik,
 - mbështetjen e familjes,
 - mbrojtjen e grupeve vulnerabël.

Këto dispozita krijojnë bazën që pushteti vendor të ndërmarrë politika fiskale mbështetëse për gratë kryefamiljare, si kategori me përgjegjësi të shtuar sociale dhe ekonomike.

2. Arsye ekonomike dhe sociale të thelluara

Gratë kryefamiljare me fëmijë në ngarkim përballen me:

- përgjegjësi të vetme për sigurimin e të ardhurave familjare,
- vështirësi në balancimin e punës me kujdesin për fëmijët,
- akses të kufizuar në tregun formal të punës,
- mungesë kapitali fillestar për sipërmarrje,
- risk të lartë për varfëri dhe përjashtim social.

Në këtë kontekst:

- sipërmarrja shpesh është forma kryesore e vetëpunësimit,
- tarifat vendore përbëjnë barrë reale në fazat e para të aktivitetit,
- mungesa e lehtësimeve fiskale mund të çojë në mbyllje të hershme të biznesit ose informalitet.

3. Baza ligjore në Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore (Ligji nr. 139/2015)

Ky ligj i njeh bashkisë kompetencën për:

- zhvillimin ekonomik lokal,
- mbështetjen e familjeve dhe grupeve në nevojë,
- nxitjen e punësimit dhe vetëpunësimit,
- hartimin e politikave sociale dhe fiskale me karakter mbështetës.

Përmes kësaj mase, bashkia ushtron drejtpërdrejt funksionet e saj sociale dhe ekonomike.

4. Baza ligjore në Ligjin nr. 9632 “Për sistemin e taksave vendore”

Ky ligj parashikon:

- autonomi fiskale për njësitë e vetëqeverisjes vendore,
- të drejtën për të vendosur përjashtime dhe lehtësime,
- mundësinë për politika fiskale me karakter social.

Përjashtimi nga tarifat vendore përbën një instrument të ligjshëm për mbështetjen e kësaj kategorie.

5. Parimi i barazisë dhe diskriminimit pozitiv

Gratë kryefamiljare nuk janë në kushte të barabarta me subjektet e tjera ekonomike për shkak të:

- barrës së shtuar familjare,
- kufizimeve në kohë dhe burime,
- vështirësive strukturore në tregun e punës.

Për këtë arsye, përjashtimi fiskal:

- është masë e justifikuar,
- përfaqëson diskriminim pozitiv të ligjshëm,
- synon barazinë reale në mundësi ekonomike.

6. Parimi i zhvillimit lokal dhe efikasitetit fiskal

- Mbështetja e sipërmarrjes së grave rrit pjesëmarrjen ekonomike në komunitet.
- Rrit stabilitetin ekonomik të familjeve me fëmijë.
- Ul varësinë nga skemat e ndihmës sociale.
- Në afatgjatë, krijon subjekte të qëndrueshme që kontribuojnë në buxhetin vendor.

Kjo masë përbën investim social dhe ekonomik për bashkinë.

7. Përcaktimi që duhet të hyjë në Paketën Fiskale

Formulim i propozuar:

“Përrjashtim i tarifave vendore për subjektet dhe sipërmarrjet e drejtuara nga gratë kryefamiljare me fëmijë nën 22 vjeç.”

8. Përfundim

Kjo masë:

- Nxit vetëpunësimin dhe fuqizimin ekonomik të grave.
- Mbështet familjet me fëmijë në ngarkim.
- Ul varfërinë dhe përjashtimin social.
- Rrit formalizimin e aktiviteteve ekonomike.
- Përputhet plotësisht me kuadrin kushtetues dhe ligjor në fuqi.

RELACION SQARUES

Përrjashtim i tarifave lokale për një periudhe 2 vjeçare dhe 1 vjeçare, për biznese, sipërmarrjet e e reja, përfitues të granteve/ start up-ve nga Bashkia Shkodër dhe start up-ve/ programeve të vetëpunësimin nga AKPA.

1. Baza kushtetuese dhe parimet e mbrojtjes sociale dhe ekonomike

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton:

- **Neni 52** – Mbrojtja sociale për personat në nevojë.
- **Neni 59** – Objektivat sociale të shtetit, përfshirë:
 - punësimin,
 - zhvillimin ekonomik,
 - mbështetjen e të rinjve dhe inovacionit,
 - nxitjen e vetëpunësimin.

Këto parime krijojnë bazën që pushteti vendor të ndërhyjë me politika lehtësuese për të rinjtë, të cilët përballen me vështirësi reale në hyrjen në tregun e punës dhe në krijimin e sipërmarrjeve të qëndrueshme.

2. Arsye ekonomike dhe sociale të thelluara

Subjektet e reja, edhe kur përfitojnë grante apo mbështetje nga programe publike (Bashkia Shkodër, AKPA):

- Kanë mungesë eksperience në menaxhimin e biznesit.
- Përballen me risk të lartë dështimi në vitet e para.
- Kanë akses të kufizuar në financa dhe kredi.
- Kanë të ardhura të paqëndrueshme në fazën fillestare.

Tarifat vendore në këtë fazë:

- ndikojnë drejtpërdrejt në likuiditetin e biznesit,
- rrisin riskun e mbylljes së aktivitetit,
- dekurajojnë formalizimin.

3. Baza ligjore në Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore (Ligji nr. 139/2015)

Ky ligj i jep bashkisë kompetencë për:

- zhvillimin ekonomik lokal,
- nxitjen e punësimit të rinjve,
- mbështetjen e iniciativave sipërmarrëse,
- hartimin e politikave fiskale me karakter zhvillimor.

Mbështetja fiskale për të rinjtë është instrument konkret për realizimin e këtyre funksioneve.

4. Baza ligjore në Ligjin nr. 9632 “Për sistemin e taksave vendore”

Ky ligj parashikon:

- autonomi fiskale të njësive vendore,
- të drejtën për përjashtime dhe lehtësime,
- përdorimin e politikave fiskale për zhvillim ekonomik.

Përjashtimi për vitet e para krijon një mjedis mbështetës për konsolidimin e bizneseve të reja.

5. Parimi i barazisë dhe diskriminimit pozitiv

Të rinjtë nuk janë në kushte të barabarta me sipërmarrësit e konsoliduar:

- mungesë kapitali,
- mungesë rrjeti dhe tregu,
- risk më i lartë dështimi.

Për këtë arsye, trajtimi preferencial përbën një formë të ligjshme të diskriminimit pozitiv, që synon barazinë reale në treg.

6. Parimi i zhvillimit lokal dhe efikasitë fiskale

- Start-up-et janë motor i inovacionit dhe zhvillimit lokal.
- Mbështetja në fazën fillestare rrit normën e mbijetesës së tyre.
- Në afatgjatë, këto biznese kontribuojnë në rritjen e të ardhurave vendore dhe punësimit.

Kjo masë përbën investim zhvillimor dhe jo kosto fiskale.

7. Përcaktimi për Paketën Fiskale

Formulim i propozuar:

“Përfshirje e tarifave lokale për një periudhë 2-vjeçare për bizneset dhe sipërmarrjet përfitues të granteve/start-up-eve nga Bashkia Shkodër dhe përfshirje e tarifave lokale për një periudhë 1-vjeçare për bizneset dhe sipërmarrjet përfituese të programeve të vetëpunësimit nga AKPA.”

8. Përfundim

Kjo masë:

- Nxit sipërmarrjen rinore.
- Rrit formalizimin e bizneseve.
- Ul papunësinë tek të rinjtë.
- Mbështet inovacionin dhe zhvillimin lokal.
- Përfshirje plotësisht me kuadrin ligjor në fuqi.

RELACION SQARUES

- Zbritje e tarifave lokale (pastrim, gjelbërim, ndricim) me 50% për çdo biznes me xhiro 0-8 milion që punëson punonjës të komunitetit rom dhe egjiptian, për 12 Muaj, pa shkeputje.

1. Baza kushtetuese dhe parimet e barazisë sociale

Kushtetuta garanton:

- **Barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimin,**
- **Mbrojtjen e grupeve vulnerabël,**
- **Nxitjen e integritetit social dhe ekonomik.**

Kjo krijon detyrimin për politika aktive që mbështesin përfshirjen e komuniteteve rom dhe egjiptian.

2. Arsye ekonomike dhe sociale të thelluara

Komunitetet rom dhe egjiptian përballen me:

- nivele të larta papunësie,
- përjashtim nga tregu formal i punës,
- nivel të ulët arsimimi dhe aftësish profesionale,
- stigmatizim dhe diskriminim.

Bizneset shpesh hezitojnë t'i punësojnë për shkak të:

- perceptimeve negative,
- kostove të integritit në punë.

Lehtësimi fiskal:

- ul koston për biznesin,
- krijon stimul real për punësim,
- ndihmon integrimin social.

3. Baza ligjore në Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore (Ligji nr. 139/2015)

Bashkia ka kompetencë për:

- përfshirjen sociale,
- nxitjen e punësimit,
- mbështetjen e grupeve në nevojë,
- hartimin e politikave sociale dhe ekonomike.

4. Baza ligjore në Ligjin nr. 9632

Ligji lejon:

- diferencim të tarifave vendore,
- aplikimin e lehtësimeve me karakter social,
- politika fiskale që nxisin zhvillimin dhe përfshirjen.

5. Parimi i diskriminimit pozitiv

Kjo masë:

- nuk krijon privilegj të padrejtë,
- por kompenson disavantazhet strukturore të komuniteteve rom dhe egjiptian.

Është një mekanizëm i ligjshëm për arritjen e barazisë reale në punësim.

6. Parimi i zhvillimit lokal dhe efijencës fiskale

- Rritja e punësimit ul varfërinë dhe varësinë nga ndihma ekonomike.
- Formalizimi i punës rrit kontributet dhe stabilitetin social.
- Bashkia përfiton në afatgjatë nga një ekonomi më e integruar.

7. Përcaktimi për Paketën Fiskale

Formulim i propozuar:

“Zbritje në masën 50% të tarifave vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim) për subjektet me xhiro vjetore 0–8 milion lekë, të cilat punësojnë punonjës nga komuniteti rom dhe egjiptian për 12 Muaj, pa shkeputje.”

8. Përfundim

Kjo masë:

- Nxit punësimin e grupeve të marginalizuara.
- Ul përjashtimin social.
- Përmirëson kohezionin social në komunitet.
- Mbështet bizneset e vogla.
- Përputhet me kuadrin ligjor dhe politikat sociale vendore.

RELACION SQARUES

Për përjashtimin nga tarifa e kopshtit dhe çerdhes për kategori vulnerabël të fëmijëve dhe familjeve

Përcaktimi që duhet të hyjë në Paketën Fiskale

Formulim i propozuar:

“Përjashtohen nga tarifa e kopshtit dhe çerdhes fëmijët që i përkasin kategorive të mëposhtme:

1.Fëmijë, ku njëri ose të dy prindërit janë me aftësi të kufizuara, fizike ose mendore, sipas vlerësimit të Komisionit Mjeko-Ligjor, dhe të ardhurat familjare janë në nivelin e pagës minimale ose më poshtë.

2.Fëmijët e familjeve me kryefamiljare gra, ose në rastet e dhunës në familje me Urdhër Mbrojtjeje (UM). Në rastet kur nëna dhe fëmija janë të sistemuar në strehëza, ata

përrjashtohen menjëherë nga tarifa, për periudhën e vlefshmërisë së UM-së, vetëm me vendimin gjyqësor të UM-së, pa kërkuar dokumente shtesë.

3. Fëmijët me aftësi të kufizuara, sipas raportit mjeko-ligjor.

4. Fëmijët e familjeve pa të ardhura ose me të ardhura shumë të ulëta, përfshirë përfituesit e ndihmës ekonomike ose të pagesës së aftësisë së kufizuar.

Drejtoria e Kulturës e Bashkisë Shkodër, në kuadër të mbështetjes së zhvillimit kulturor dhe nxitjes së industrive kreative në qytet, paraqet për shqyrtim këtë propozim lidhur me aplikimin e lehtësirave fiskale për subjektet dhe veprimtaritë artistike dhe kulturore.

Spektori i artit dhe kulturës përfshin një gamë të gjerë subjektësh dhe veprimtarish, si: artet pamore (galeri dhe dyqane pikturash), skulptorë, muzikantë, studio muzikore, shtëpi botuese. Këto veprimtari kontribuojnë ndjeshëm në pasurimin e jetës kulturore, edukimin estetik të komunitetit, promovimin e identitetit kulturor lokal, si dhe në zhvillimin e turizmit kulturor.

Në këtë kuadër, propozohet shqyrtimi i mundësisë për aplikimin e lehtësirave fiskale për artistët dhe veprimtaritë artistike.

Mbështetja fiskale për artistët do të ndikojë pozitivisht në formalizimin e sektorit kulturor, rritjen e prodhimit artistik duke sjellë përfitime afatgjata kulturore dhe ekonomike për komunitetin.

Drejtoria e Sportit

Në kuadër të politikave vendore për promovimin e aktivitetit fizik, përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe zhvillimin e sportit në komunitet, Drejtoria e Sportit paraqet këtë relacion me qëllim shqyrtimin e mundësisë për përjashtimin nga taksat vendore të subjekteve private që kanë në pronësi ose administrim terrene sportive, të cilat përdoren ekskluzivisht për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Terrenet sportive private përbëjnë një aset të rëndësishëm për qytetin, pasi rrisin mundësitë për praktikimin e sportit nga qytetarët e të gjitha grupmoshave, lehtësojnë ngarkesën mbi infrastrukturën sportive publike dhe krijojnë hapësira shtesë për organizimin e aktiviteteve sportive, turneve dhe eventeve komunitare. Prania dhe funksionimi i këtyre terreneve kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e shëndetit publik, në rritjen e përfshirjes sociale dhe në reduktimin e problematikave që lidhen me mungesën e aktiviteteve fizike, veçanërisht tek të rinjtë.

Nga ana tjetër, bizneset që investojnë në terrene sportive përballen me kosto të konsiderueshme mirëmbajtjeje dhe operimi, duke përfshirë shpenzimet për energji elektrike, ujë, mirëmbajtjen e sipërfaqeve sportive, riparimet periodike, si dhe investimet e vazhdueshme në pajisje teknologjike dhe standarde sigurie. Këto kosto ndikojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë financiare të subjekteve dhe në çmimin e shërbimeve që ato ofrojnë për qytetarët. Në këtë kontekst, përjashtimi nga taksat vendore do të shërbente si

një stimul konkret për bizneset që investojnë në infrastrukturë sportive dhe e vënë atë në funksion të komunitetit, duke krijuar kushte më të favorshme për zhvillimin e aktivitetit sportiv në qytet.

Zbatimi i këtij përjashtimi pritet të sjellë një sërë përfitimesh për bashkinë dhe komunitetin, pasi do të ndikojë në rritjen e numrit të terreneve sportive funksionale, në përfshirjen më të madhe të rinjve dhe qytetarëve në aktivitete sportive dhe në lehtësimin e organizimit të eventeve sportive në bashkëpunim me sektorin privat. Gjithashtu, kjo masë do të nxisë investime të reja në infrastrukturë sportive dhe do të krijojë mundësi më të mëdha për zhvillimin e sportit në nivel lokal.

Për të garantuar që ky përjashtim të zbatohet në mënyrë të drejtë dhe të orientuar drejt interesit publik, propozohet që subjektet përfituese të jenë të regjistruara për ushtrimin e aktivitetit sportiv, të kenë në pronësi ose administrim terrene sportive të dedikuara vetëm për aktivitete sportive dhe të mos i përdorin ato për aktivitete të tjera tregtare që nuk lidhen me sportin. Gjithashtu, është e rëndësishme që këto subjekte të bashkëpunojnë me bashkinë për zhvillimin e aktiviteteve komunitare, sociale ose sportive, sipas marrëveshjeve të veçanta.

Në përfundim, Drejtoria e Sportit propozon që të shqyrtohet mundësia ligjore dhe financiare për përfshirjen e këtij përjashtimi në paketën fiskale vendore, si dhe hartimin e kriteve dhe procedurave për përfitimin e tij, në përputhje me politikat për promovimin e sportit, shëndetit publik dhe përfshirjes sociale në komunitet.

RELACION SQARUES

Versioni i riformuluar dhe i saktësuar

Taksat dhe tarifat vendore për familjet pa kontratë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime të Qarkut Shkodër sh.a.

1. Përkufizimi i kategorisë tatimpaguese

Familjet të cilat nuk kanë kontratë të furnizimit me ujë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime të Qarkut Shkodër sh.a., sipas rregullave të aplikueshme për shërbimet publike, faturohen drejtpërdrejt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (DTTV) të Bashkisë Shkodër për detyrimet tatimore vendore, me bazë vjetore, në përputhje me ligjin nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

2. Regjistrimi dhe përcaktimi i detyrimit tatimor

Për çdo familje të re, detyrimi tatimor vendor llogaritet duke filluar nga **muaji pasardhës** i regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse. Në zbatim të parimit të momentit të lindjes së detyrimit tatimor, sipas ligjit për taksat vendore, afati i pagesës së detyrimeve të paraqitura në faturën vjetore është **30 (tridhjetë) ditë kalendarike** nga data e regjistrimit të familjes në regjistrin civil të Bashkisë Shkodër.

3. Trajtimi i rasteve me vështirësi ekonomike

Në rastet kur tatimpaguesi familjar deklaron pamundësi financiare për të shlyer detyrimet e plota tatimore brenda afatit të përcaktuar, DTTV mundëson lidhjen e një akt-marrëveshjeje dhe planit të pagesave për shlyerjen me këste të detyrimeve, në

përputhje me Udhëzimin nr. 17, datë 15.06.2022 “Për procedurat e mbledhjes së detyrimeve të prapambetura”.

Akt-marrëveshja për shlyerje me këste lejohet vetëm pasi tatimpaguesi të vërtetojë gjendjen e vështirësisë së tij ekonomike dhe sociale përmes dokumentacionit zyrtar.

4. Dokumentacioni i nevojshëm për vërtetimin e pamundësisë financiare

Për të përfituar nga akt-marrëveshja për shlyerjen e detyrimit me këste, tatimpaguesi familjar duhet të paraqesë pranë DTTV dokumentacionin e mëposhtëm, sipas kërkesave të udhëzimit dhe praktikës administrative:

- **Vërtetim nga Njësia Administrative** për gjendjen ekonomike të familjes.
- **Vërtetim të të ardhurave** nga ISSH, për personat që marrin pension ose ndihmë ekonomike.
- **Deklaratë të të ardhurave familjare** për personat pa të ardhura të deklarueshme.
- **Kopje të dokumenteve identifikuese** të anëtarëve të familjes.
- Çdo dokument tjetër mbështetës që provon gjendjen ekonomike apo sociale të familjes (p.sh. vërtetim papunësie, vërtetim invaliditeti, vendim për kujdestari, etj).

Vendim-marrja për miratimin e akt-marrëveshjes bëhet nga DTTV bazuar në analizën ekonomike të familjes dhe në përshtatshmërinë e planit të pagesave të propozuar.

RELACION SQARUES

Parashkrimi i detyrimeve tatimore vendore

Neni 21 i Ligjit nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Ky nen sqaron se:

- **Taksat vendore administrohen sipas parimeve të Ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore”.**
- Aty ku ligji vendor nuk ka parashikim specifik, zbatohen dispozitat e ligjit tatimorë të përgjithshëm (analogjikisht dhe të përshtatura).

Kjo do të thotë:

Rregulli i parashkrimit 5-vjeçar i ligjit 9920 zbatohet edhe për detyrimet vendore.

Ligji nr. 9920/2008 - Nenet 73, 100 dhe 102.

Nenet e sipërcituara përcaktojnë qartë se:

Detyrimet tatimore parashkruhen brenda 5 viteve.

Afati llogaritet nga data kur tatimi duhej paguar.

Administrata tatimore (edhe ajo vendore) nuk mund të kërkojë mbledhjen e detyrimeve të parashkruara.

Parashkrimi ndërpritet vetëm kur administrata vendore ka marrë masa formale (njoftime zyrtare, vendime këshilluese, vendosje barrë sigurie, masa të ekzekutimit etj.).

RELACION SQARUES

Përmbledhje për Paketën Fiskale - Neni 6 “Detyrimi Tatimor” (Ligji Nr. 9920/2008, i ndryshuar)


Detyrimi tatimor lind në momentin kur një person (individ apo subjekt juridik) realizon të ardhura, bëhet pronar i një pasurie, apo kryen pagesa që përbëjnë objekt tatimi sipas legjislacionit tatimor. Ky detyrim konsiderohet i vlefshëm edhe në rastet kur aktiviteti, të ardhurat apo zotërimi i pasurisë kryhen në mënyrë të jashtëligjshme; në këto raste tatimi përlllogaritet për të gjithë periudhën kur personi ka përfituar nga pasuria ose aktiviteti në fjalë.

Detyrimi tatimor përfshin **tatimin, kamatëvonesat dhe gjobat** e parashikuara nga ligji. Për individët që kanë ndërruar jetë, detyrimi pushon në datën e vdekjes, duke kaluar si detyrim tek **trashëgimtarët ligjorë**. Ndërsa për personat juridikë që likuidohen, detyrimi pushon në datën e likuidimit dhe përgjegjës për llogaritjen e tij mbetet **likuidatori ose përfaqësuesi ligjor**.

Të gjitha detyrimet tatimore llogariten dhe paguhen në **monedhën kombëtare**, përveç rasteve kur një dispozitë e veçantë ligjore parashikon ndryshe.

Norma synon të sigurojë që të gjithë individët dhe subjektet, përfshirë ata që realizojnë përfitime jashtë sistemit të ligjshëm, të trajtohen në mënyrë të barabartë për qëllime tatimore. Mungesa e një dispozite të tillë do të krijonte hapësira për abuzim, duke i lejuar ata që përfitojnë në mënyrë të jashtëligjshme që të shmangnin kontributin tatimor.

Dispozita e Nenit 6, pika 2, ka një rëndësi të veçantë në luftën kundër evazionit fiskal, duke e bërë të qartë se detyrimi tatimor lind pavarësisht ligjshmërisë së burimit të të ardhurave apo mënyrës së përfitimit të pasurisë. Kjo normë i jep autoritet administratës tatimore për të përfshirë në bazën tatimore të ardhurat e jashtëligjshme dhe për të siguruar që çdo përfitim financiar në Shqipëri është subjekt i sistemit tatimor.



Zv/Kryetar 	Zv/Kryetar 
Zv/Kryetar 	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore 
Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit DANDI LACO  Drejtoria e Sportit  Drejtoria e Kulturës 	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit  Drejtoria e Shërbimeve Sociale 
Drejtoria e Arsimit 	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit 
Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik 	IMT 



PAKETA FISKALE BASHKIA SHKODER

Kapitulli I: Taksat vendore

Ky kapitull trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

I.1 Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Shfuqizuar me Ligjin 29/2023 Per tatimin mbi te ardhurat, nenet 71 dhe 72.

I.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme është një burim i rëndësishëm i të ardhurave vendore dhe zbatohet mbi ndërtesat, tokën bujqësore dhe truallin në pronësi ose përdorim të individëve apo subjekteve juridike. Taksa llogaritet mbi bazën e vlerës së pasurisë/ çmimi referues sipas përcaktimeve ligjore dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe Këshillit Bashkiak.

Përkufizimi	Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.
Kategoritë	a) taksa mbi ndërtesat; b) taksa mbi tokën bujqësore; c) taksa mbi truallin
Baza e taksës	Ndërtesat: Baza e taksës është vlera e ndërtesës, e llogaritur sipas metodologjisë dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Toka bujqësore: Baza e taksës është sipërfaqja në hektare e tokës në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Trualli: Baza e taksës është sipërfaqja në metra katrorë e truallit në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

1.2.1 Taksa mbi ndërtesat

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.
2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme - ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Si bazë për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës, do të shërbejë VKM nr.132, datë 07.03.2018 e ndryshuar.

Për qëllim të zbatimit të metodologjisë për përcaktimin e bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, termat e mëposhtëm kanë kuptimin si më poshtë vijon:

1. **“Çmim vlerësues”**, njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar i përcaktuar me këtë metodologji.
2. **“Ndarje/nënndarje zonale”**, një rajon territorial brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore me emër dhe numër kadastral unik. Këto ndarje/nënndarje paraqiten në parcela tokësore me kufij të përcaktuar, që i ndajnë ato nga njëra-tjetra.
3. **“Ndërtesë”**, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekti i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.
4. **“Ndërtesë e papërfunduar”**, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
5. **“Njësi pronësore”**, ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.
6. **“Ndarje e njësisë pronësore për banim”**, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.
7. **“Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike”**, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.
8. **“Përdorues”**, individi, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

9. “Regjistër qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme” (Kadastra fiskale), sistemi qendror i bazës së të dhënave, i cili shërben për hedhjen, përpunimin, korrektimin e të dhënave, të cilat lidhen me pasurinë e paluajtshme dhe që shërbejnë për efekt të llogaritjes së shumës së taksës së pasurisë së paluajtshme për t’u paguar nga çdo taksapagues. Ky regjistër ofron informacion për përdoruesit.

10. “Taksapagues”, çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesë” e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

11. “Vlerë e pasurisë”, vlera aktuale e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore e njohur me dokumente ligjore ose vlera e përcaktuar me një nga metodat e përshkruara në këtë metodologji. Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njesisë pronësore.

12. “Veprimtari ekonomike”, çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

Përfundime

Përfundohen nga taksa mbi ndërtesat:

- a. ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- b. ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- c. ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- d. ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohej mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.
- e. ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qera të paliberalizuara;
- f. banesat sociale në pronësi të bashkive;
- g. pasuritë e paluajtshme - ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkinë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- h. pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- i. pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;

- j. strukturat akomoduese “**Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special**”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- k. Janë të përjashtuara nga taksa mbi ndërtesën, ndërtesat në pronësi ose në përdorim të Kishës Katolike, të enteve të saj dhe të institucioneve të saj të para shikuara në Kodin e së Drejtës Kanonike, të themeluara nga autoriteti kompetent kishtar si persona juridikë kishtar ose të njohura si organizata pa qëllim fitimi të Kishës Katolike dhe të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore shqiptare, në rastet kur ato përdoren për ushtrimin e kultit, drejtimin dhe administrimin kishtar, veprimtarinë baritore, humanitare dhe bamirëse, formimin e meshtarëve dhe të rregulltarëve, mësimin e teologjisë dhe të shkencave të tjera kishtarë, si dhe për banimin e mbarështuesve të kultit dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kishës.
- Përjashtimet e parashikuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje nuk do të zbatohen në rast se ndërtesat në të, të përmendura, do të përdoren për veprimtari që kanë qëllim fitimi. Në këtë rast do të zbatohet legjislacioni në fuqi duke mbajtur parasysh tarifën e caktuar prej organeve të pushtetit lokal.
- Për ndërtesat dhe ambientet e caktuara për veprimtari edukative dhe shkollore, edhe universitare e pasuniversitare, shoqërore dhe shëndetësore, në pronësi ose në përdorim të enteve dhe të institucioneve të parashikuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohet tarifa e caktuar prej organeve të pushtetit lokal, e cila nuk duhet të jetë më e madhe se tarifa e përcaktuar për organizatat e tjera pa qëllim fitimi që zhvillojnë të njëjtat veprimtari, duke llogaritur vetëm sipërfaqen e ambientit në të cilin zhvillohen veprimtaritë e parashikuara.

Baza e taksës

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Shkalla e taksës

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Që nga data 01.01.2019 aplikohet nënndarje zonale ku përfshihen të gjitha njësitë administrative (përveç zonës së qytetit dhe zonave të plazhit Velipoje dhe Baks/ Rrjoll), për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës minus 30 (tridhjetë) për qind për çdo lloj ndërtese.

ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI, PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME, PËR BANESAT, ANEKSI 1 A.1.10/45

SHKODËR

58,000

Lekë/m² sipërfaqe shfrytëzimi

Çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim:

- a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.
- b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit.
- c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit
- ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijë ato të njërive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse.
Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura
- d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor
- dh) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK – Bazuar në VKM nr. 457/2023
- e) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë. *Eshte per ndërtesat per banim*

Strukturat përgjegjëse për përlogaritjen dhe vjeljet e taksës:

Detyrimi për familjarët llogaritet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë ose vetëm për taksat dhe tarifatat vendore, pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a., në cilësinë e agentit tatimor. Për shërbimin, agjenti përfiton përkatësisht 2% (dy përqind) të shumës së arkëtuar.

Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin faturohen drejtpërdrejt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkinë Shkodër, mbi bazë vjetore.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, në sportelet të Posta Shqiptare sh.a dhe sportelet e Unionit Financiar Tiranë, brenda datës 30 qershor të vitit fiskal.

TABELA PËRMBLEDHËSE - TAKSA VENDORE MBI NDËRTESESËN

Nr.	Kategoria e ndërtesës	Baza e taksimit / Çmimi referues	Shkalla e taksës	Norma efektive (kur ka reduktim)	Formula e llogaritjes	Shembull (me 58 000 lekë/m ² & 1 m ²)
1	Ndërtesa për veprimtari ekonomike por të pashfrytëzuara (pa aktivitet brenda tyre) në qytet, Velipojë Plazh-Baks Rrjoll	58,000	0.2%	-	$\text{Çmimi} \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2\%$	116 lekë
2	Ndërtesa për veprimtari ekonomike por të pashfrytëzuara (pa aktivitet brenda tyre) në Nj.A.	58,000	0.2%	30%	$\text{Çmimi} \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2 \times 70\%$	81.2 lekë
3	Ndërtesa të papërfunduara (leje e tejkaluar në afat)	Kosto ndërtimi nga leja	30% e shkallës ligjore të taksës (që është 0,05% për banim dhe 0,2% për ndërtesa social-ekonomike)	-	$30\% \times \text{shkalla e taksës (0,05\% ose 0,2\% sipas llojit të ndërtesës)} \times \text{kosto e ndërtimit (sipërfaqja totale sipas rastit; për banim ose për ndërtesa social-ekonomike)}$	Banasa: $30\% \times \text{shkalla}$ $0,05\% \times \text{kosto e ndërtimit për ambientet e banimit}$ Njësi Tregtare: $30\% \times \text{shkalla } 0,2\% \times \text{kosto e ndërtimit për ambientet social-ekonomike}$

4	Ndërtesa për tregti / shërbim në qytet, Velipojë Plazh-Baks Rrjoll	1.5 × 58,000	0.2%	-	$(\text{Çmimi} \times 1.5) \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2\%$	174 lekë
5	Ndërtesa për tregti / shërbim në Nj.A.	1.5 × 58,000	0.2%	30%	$(\text{Çmimi} \times 1.5) \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2\% \times 70\%$ (vlera e mbetur)	122 lekë
6	Parkim i mbuluar / bodrum në qytet, Velipojë Plazh-Baks Rrjoll	70% e 58,000	0.2%	-	$(\text{Çmimi} \times 70\%) \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2\%$	81,2 lekë
7	Parkim i mbuluar / bodrum në Nj.A.	70% e 58,000	0.2%	30%	$(\text{Çmimi} \times 70\%) \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2\% \times 70\%$	56.8 lekë
8	Parkim i hapur / pishina / ambiente sportive të hapura në qytet, Velipojë Plazh-Baks Rrjoll	30% e 58,000	0.2%	-	$(\text{Çmimi} \times 30\%) \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2\%$	34,8 lekë
9	Parkim i hapur / pishina / ambiente sportive të hapura në Nj.A.	30% e 58,000	0.2%	30%	$(\text{Çmimi} \times 30\%) \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2\% \times 70\%$	24.4 lekë
10	Ndërtesa arsimore / sportive të mbyllura në qytet, Velipojë Plazh-Baks Rrjoll	50% e 58,000	0.2%	-	$(\text{Çmimi} \times 50\%) \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2\%$	58 lekë
11	Ndërtesa arsimore / sportive të mbyllura në Nj.A.	50% e 58,000	0.2%	30%	$(\text{Çmimi} \times 50\%) \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2\% \times 70\%$	40.6 lekë
12	Ndërtesa për prodhim të të gjitha llojeve në qytet, Velipojë Plazh-Baks Rrjoll	50% e 58,000	0.2%	-	$(\text{Çmimi} \times 50\%) \times \text{m}^2 \times 0.2\%$	58 lekë
13	Ndërtesa për prodhim të të gjitha llojeve në Nj.A.	50% e 58,000	0.2%	30%	$(\text{Çmimi} \times 50\%) \times 1 \text{ m}^2 \times 0.2\% \times 70\%$	40.6 lekë

14	Ndërtesa të reja (5 vitet e para - VKM 457/2023) në qytet, Velipojë Plazh-Baks Rrjoll	58,000 + (58.000 × 0.2 herë)	0.2%	-	Çmimi + (Çmimi × 0.2) × 1 m ² × 0.2%	139.2 lekë
14	Ndërtesa të reja (5 vitet e para - VKM 457/2023) në Nj.A.	58,000 + (58.000 × 0.2 herë)	0.2%	-	Çmimi + (Çmimi × 0.2) × 1 m ² × 0.2% x 70%	97.4 lekë
15	Ndërtesa për bujqësi & blegtori në qytet, Velipojë Plazh-Baks Rrjoll	30% e 58,000	0.2%	-	(Çmimi × 30%) × 1 m ² × 0.2%	34,8 lekë
16	Ndërtesa për bujqësi & blegtori në Nj.A.	30% e 58,000	0.2%	30%	(Çmimi × 30%) × 1 m ² × 0.2% x 70%	24.4 lekë

SQARIM

Nëse një ndërtesë social-ekonomike (dyqan etj) mund të hapet dhe mbyllet më shumë se një herë gjatë një viti fiskal, atëherë taksë për ndërtesën do të përlogaritet në fillim të vitit fiskal dhe do të paguhet e plotë duke marrë për bazë që ndërtesa është në aktivitet të plotë. Më pas, në fund të vitit fiskal nëse ndërtesa ka pësuar ndryshime në kategori pra ka qëndruar e mbyllur për një periudhë kohe dhe më pas është hapur, do të bëhet përlogaritja përfundimtare në fund të vitit fiskal duke bërë edhe zbritjet përkatëse. Shuma që ka rezultuar me tepricë kreditore në favor të pronarit/poseduesit do të kalojë në zërin “taksë ndërtesë” për llogari të periudhave pasardhëse.

Udhëzim sqarues: Nëse gjatë një periudhe kohore të caktuar ndodh mbyllja e një ndërtesë social-ekonomike, pronari/poseduesi i saj ka detyrimin të njoftojë menjëherë Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë e cila me pas mban akt-konstatimin në subjekt në lidhje me gjendjen faktike të ndërtesës. Nëse pronari/poseduesi i ndërtesës nuk njofton Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore në lidhje me gjendjen e ndërtesës (e hapur apo e mbyllur), përlogaritja e taksës së ndërtesës do të bëhet e plotë, sikur objekti social-ekonomik është në aktivitet.

I.2.2 Taksë mbi tokën bujqësore

Përkufizimi: “Tokë bujqësore” është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të marrjes së tokës nëpronësi, certifikatës së regjistrimit të tokës. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore **bën një vetëdeklarim** të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore caktohet në Lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Kategoritë mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore	
		Sipas ligjit	Miratuar
I	Lekë/ha/vit	4,200	2,940
II	Lekë/ha/vit	3,500	2,450
III	Lekë/ha/vit	2,800	1,960
IV	Lekë/ha/vit	2,300	1,610
V	Lekë/ha/vit	1,900	1,330
VI	Lekë/ha/vit	1,600	1,120
VII - X	Lekë/ha/vit	1,400	980

Përgjegjësia	Struktura përkatëse
Vlerësimi dhe përlllogaritja e taksës	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore
Vlerësimi i kategorisë së tokës dhe verifikimi i periudhës së mbjelljes	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP
Përcaktimi i sipërfaqes në pronësi dhe pasqyrimi i ndryshimeve	Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP (me raportim periodik për Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore)
Arkëtimi i detyrimit	Ujësjetës Kanalizime sh.a. (për familjarët) dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (për bizneset)

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi planifikohet nga drejtoria e bujqësisë zhvillimit rural dhe trajtimit të AMTP, përlllogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe për familjarët shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjetës Kanalizime - Qarku Shkodër sh.a., në cilësinë e agentit tatimor. Për shërbimin, agjenti përfiton përkatësisht 2% (dy përqind) të shumës së arkëtuar. Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me ujësjetësin faturohen direkt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkinë Shkodër, me bazë vjetore.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, ne sportelet e Posta Shqiptare sh.a dhe sportelet e Unionit Financiar Tiranë, brenda datës 30 qershor të vitit fiskal.

Përrjashtime: Përrjashtohen nga taksa, tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për planifikimin e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit të AMTP. Struktura e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore, për të gjitha kategoritë, është Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Shkodër.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit të AMTP, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe trajtimit të AMTP, për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme, duke ia përcjellë këtë informacion me shkrim Drejtorisë përgjegjëse për Taksat dhe Tarifave Vendore, për llogaritjen e detyrimit.

1.2.3 Taksa mbi truallin

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit **bën një vetëdeklarim** të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Tabelë 4. Niveli i taksës mbi truallin

Taksa mbi truallin	Njësia	Niveli i taksës mbi truallin
		Sipas ligjit
Për qëllime banimi nga individët	Lekë/m ² /vit	0,42
Për qëllime biznesi	Lekë/m ² /vit	18

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifave Vendore kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :

Detyrimi për familjarët shlyhet si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime - Qarku Shkodër sh.a., në cilësinë e agentit tatimor. Për shërbimin, agjenti përfiton përkatësisht 2% (dy përqind) të shumës arkëtruar në favor të Bashkisë Shkodër.

Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve me Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime - Qarku Shkodër sh.a., faturohen direkt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër, me bazë vjetore.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, në sportelet e Posta Shqiptare sh.a dhe sportelet e Unionit Financiar Tiranë, brenda datës 30 qershor të vitit fiskal.

Mbas vetëdeklarimit të bërë nga kategoritë “Familjar” dhe “Biznes” Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore mund të bëjë verifikimin edhe vlerësimin në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi

dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin, pagesa që rezulton nga konstatimi i ri, do të përlllogaritet për të gjithë periudhën. Tatimpaguesi biznes, i cili nuk paguan, brenda afatit të parashikuar, shumë e detyrimit tatimor detyrohet të paguajë një **gjobë, të barabartë me 0,06 për qind** të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Përmbledhje e elementeve administrative të taksës

Elementet	Përmbajtja / Përgjegjësia
Baza e taksës	Sipërfaqja e truallit në pronësi ose përdorim të taksapaguesit (m ²)
Shkalla e taksës	<ul style="list-style-type: none"> • 0.42 lekë/m²/vit për banim; • 18 lekë/m²/vit për biznes
Afati i pagesës	Deri më datë 30 qershor të vitit fiskal
Struktura përgjegjëse për vlerësim/planifikim	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore
Strukturat përgjegjëse për arkëtim	Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime - Qarku Shkodër Sh.a. (për familjarët); Drejtoria e Taksave (për bizneset)

I.3. Taksa e fjetjes në hotel

Taksa e fjetjes në hotel është një taksë vendore që aplikohet mbi shërbimet e akomodimit në struktura pritëse si hotele, motele, shtëpi pritjeje apo njësi të tjera që ofrojnë strehim kundrejt pagesës sipas përcaktimeve të ligjit mbi turizmin. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person. Ajo llogaritet në Lekë/natë fjetje/person sipas nivelit tregues të përcaktuar në ligj.

Përkufizimi	Taksë vendore që aplikohet mbi shërbimin e akomodimit në struktura pritëse si hotele, motele, shtëpi pritjeje, apo çdo njësi tjetër që ofron strehim kundrejt pagesës sipas përcaktimeve të ligjit mbi turizmit
Kategoritë	Për qëllim të këtij ligji, me "hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim
Baza e taksës	Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person dhe llogaritet në Lekë/natë fjetje/person

- a) **“Kapacitet i strukturës akomoduese”**, numri i përgjithshëm i dhomave dhe shtretërve të saj, të vëna në dispozicion për turistët gjatë periudhës së shfrytëzimit;
- b) **“Kapacitet shfrytëzimi”**, raporti i numrit të përgjithshëm të dhomave dhe shtretërve të zënë me kapacitetin e strukturës akomoduese përgjatë periudhës së shfrytëzimit;
- c) **“Nivel minimal i shfrytëzimit të kapacitetit”**, niveli më i ulët i shfrytëzueshmërisë së kapacitetit të strukturës akomoduese përgjatë periudhës së shfrytëzimit, të përcaktuar në aktet ligjore.

Përkufizimi: Bazuar në Ligjin 93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar, strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a)“Bujtinë”; b)“Fjetinë” (Hostel); c)“Kamping”; ç)“Hotel”; d)“Motel”; dh)“Resort”; e)“Qendër kurative”; ë)“Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: “Bujtinë” Standard, “Fjetinë” Standard, Komfort; “Kamping” Standard, “Hotel” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Motel” Standard, Komfort, Superior; “Resort” tre yje, katër yje, pesë yje; “Qendër kurative” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Fjetje dhe mëngjes” (B&B) Standard, Komfort, Superior.

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Tabelë 5. Taksa e fjetjes në hotel

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
Hotel me 4-5 yje	Lekë/natë qëndrimi/ për person	175
Hotel nën 4 yje, motel, hostel, bujtinë, si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	Lekë/natë qëndrimi/ për person	70

Detyrimi dhe këstet e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifat Vendore.

Shënim: Nëse strukturat akomoduese gjatë deklarimit të fjetjeve nuk disponojnë dokumentacion mbështetës ligjor në lidhje me deklarimin e bërë apo disponojnë dokumentacion të pjesshëm tatimor, vlerësimi i netëve të fjetjeve do të bëhet në mënyrë alternative bazuar në Vendimin nr. 160, datë 12.3.2025 “Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit dhe të nivelit minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese” ose nenet 71 dhe 72 të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar.

I.4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Hyrja mund të ishte e tillë;

Taksa e ndikimit në infrastrukturë është një taksë vendore e cila kontribuon në mënyrë të rëndësishme në buxhetin e Bashkisë Shkodër e cila është një bashki me potencial zhvillimi. Të ardhurat nga kjo taksë përdoren kryesisht për zhvillimin, përmirësimin ose zgjerimin e infrastrukturës publike në territorin e njësisë vendore me qëllim kompensimin e ndikimit të investimit ndërtimor në infrastrukturën publike.

Përkufizimi	Taksë vendore që aplikohet ndaj investimeve ndërtimore, e cila synon të kompensojë ndikimin që këto ndërtime kanë mbi infrastrukturën publike ekzistuese. Kjo taksë paguhet nga subjekti ndërtues në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit dhe bazohet në vlerën e investimit që do të realizohet ose çmimin e shitjes sipas vlerës referuese, si dhe në normat e përcaktuara në ligj dhe këshilli bashkiak përkatës.
Kategoritë	a) Ndërtime për banim apo njësi tregtare/shërbimi nga shoqëri ndërtimi: b) Ndërtime për sektorin e turizmit, industrisë, banesa individuale ose publike: c) Ndërtime për bujqësi, blegtori dhe objekte sportive: d) Projekte infrastrukturore (rrugë, porte, aeroporte, energji, etj.); e) Objekte në proces legalizimi: f) Ndërtime banimi në zonat malore:
Baza e taksës	Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.

Baza e taksës: Baza e taksës është vlera në Lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në Lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë:

Bazuar në ligjin nr. Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2, përcaktohet :*“Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind deri 8 (tetë) për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t’u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit”...*

ZONA 1:

- Qendra Historike e Fshatit Theth - Shkodër e të Zonës së Mbrojtur përreth saj, miratuar me VKM nr.733, datë 8.12.2017, e cila njëkohësisht ka statusin zonë e mbrojtur “Alpet e Shqipërisë”, Park Kombëtar, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 10, datë 28.12.2020, si dhe Zonë me Përparësi Zhvillimin e Turizmit, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 26.7.2018;
- Qendra Historike e qytetit të Shkodrës dhe Zonës Mbrojtëse përreth saj, miratuar me VKM Nr.771, datë 30.9.2020;
- Bregu Perendimor i Liqenit të Shkodrës, zona Shiroke-Zogaj, e cila ka statusin “Zonë me Përparësi Zhvillimin e Turizmit”, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 26.7.2018, si dhe Zonë e Mbrojtur Liqeni i Shkodrës - Park Natyror/Rezervë Natyrore e Menaxhuar, miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 10, datë 28.12.2020;
- Velipoja, “Zonë me Përparësi Zhvillimin e Turizmit”, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 26.7.2018, si dhe pjesë e Brezit Bregdetar;
- Baks - Rrjoll, zonë e mbrojtur Lumi i Bunës - Velipojë, Peisazh Tokësor e Ujor i Mbrojtur, miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 10, datë 28.12.2020, “Zonë me Përparësi Zhvillimin e Turizmit”, miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 26.7.2018, pjese e Brezit Bregdetare, si dhe Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare (PDZRK) Baks-Rrojll dhe Rana e Hedhun-Porti Shëngjin miratuar me Vendim Nr.1, datë 28.12.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

ZONA 2 - Qytet Shkodër, duke përjashtuar zonat e sipërcituara.

ZONA 3 - Njësitë administrative të territorit të Bashkisë Shkodër, duke përjashtuar zonat e sipërcituara.

Në zonën 1, referuar statusit që këto zona kanë, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 8 (tetë) për qind.

Në zonën 2, referuar statusit që këto zona kanë, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 6 (gjashtë) për qind.

Në zonën 3, referuar statusit që këto zona kanë, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind.

Diferencimi në 3 (tre) zona ka për qëllim t'i japë një mundësi reale Bashkisë Shkodër për të realizuar një politikë nxitëse/shkurajuese për zhvillimin e zonave të caktuara të qytetit, por njëkohësisht dhe diferencimin referuar statusit dhe rëndësisë që këto zona kanë. Në rast se projekt propozimi shtrihet në dy zona do të merret përqindja e zonës ku parcela që zhvillohet ka më shumë se 50% të sipërfaqes.

Niveli i rikonceptuar i jep mundësi Bashkisë Shkodër për të investuar në infrastrukturë duke ju përgjigjur në këtë mënyrë ndërtimeve të reja dhe zonave të reja zhvillimore.

Tabelë 6. Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë

TAKSË NDIKIMI NË INFRASTRUKTURË


Nr	Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Sipas ligjit, Në % të çmimit të shitjes për m2	në %; Zona 1 (Sipas hartës)	në %; Zona 2 (Sipas hartës)	në %; Zona 3 (Sipas hartës)
1	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtime të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi. - Ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. - Ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit. 	4 - 8	8	6	4
2	Ndërtesa, më shumë se një ndërtim pa leje, në proces legalizimi (ndërtesa të dyta).	4 - 8	8	6	4

Baza e taksës: Baza e taksës është vlera në Lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njërive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.



BASHKIA
SHKODER

HARTA E ZONAVE HARTA E PERGJITHSHME E BASHKISE



Ndryshime në tabelën 7 Llojet e ndërtimeve dhe investimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër

Baza ligjore e ndryshuar:

- Ligjit Nr. 67/2023 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Neni 27 pika 3

Në paketën fiskale aktuale, **Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë** Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike sipas ligjit është nga 1-3% dhe e miratuar për Shkodër, Velipojë dhe Rrethina 3 % ndërsa për Nj.A. të tjera është 2%. Ndryshimet e reja ligjore përcaktojnë që:

Neni 27 pika 3

1. Në shkronjën “a” fjala “bujqësore” hiqet.

2. Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje: “a/1. Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksë e ndikimit në infrastrukturë është jo më shumë se 1 (një) për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është jo më shumë se 2 (dy) për qind e saj.”

Për rrjedhojë, për të saktësuar tarifimin e kësaj kategorie, është bërë saktësimi në tabelën përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë, si më poshtë:

Tabela 7 Llojet e ndërtimeve dhe investimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër

Nr.	Llojet e ndërtimeve dhe investimeve (ndërtime të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër)	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë		
		Sipas ligjit	në %	
		Në % të vlerës së investimit	NjA Shkodër, Velipojë, Rrethina	NjA të tjera
1	Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike.	1 - 3	3	2
2	Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve	1	1	1

	në legjislacionin në fuqi për sportin.			
3	Ndërtesa, më shumë se një ndërtim pa leje, në proces legalizimi (ndërtesa të dyta).	1 - 3	3	2
4	Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	0.1 por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;	0.1 por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;	0.1 por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;
5	Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5	0.5	0.5

Nëse vlera e situacionit përfundimtar është më e lartë se vlera e përlogaritur atëherë do të mbahet dhe diferenca (nëse ka) që del referuar vlerës së paguar më përpara dhe përlogaritjeve të bëra mbas dorëzimit të preventivit përfundimtar.

Në çdo rast do të mbahet vlera më e lartë midis çmimit të preventivit dhe koston së shitjes.

Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është **0,1 (zero pikë një) për qind** e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit., ne zbatim te ligjit 82/2025 “per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9632 datë 30.10.2006 per sistemin e taksave vendore i ndryshuar. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

Baza e taksës: Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

Detyrimi i pagesës: Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Përlogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive.

Struktura përgjegjëse për vlerësimin/ planifikimin/ përlogaritjen dhe vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vlerësimin/planifikimin/përlogaritjen dhe vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, legalizimet dhe tarifatat e tjera të bashkëlidhura është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë bashkisë Shkodër.

Struktura e ngarkuar për njoftimin dhe vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale

1. Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2. Nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitimi, kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit, në përputhje me standardet e miratuara në planin vendor dhe vetëm atëherë kur bashkia ka miratuar një plan vendor, atij mund t'i akordohet shtesa në intensitet përkundrejt përfitimit të një sipërfaqeje ndërtimi në favor të bashkisë, për strehim social, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit⁶.

Kushte lehtësuese: Në rast të zbatimit të një projekti të veçantë për eficientë e energjisë urbane⁷, projekti verifikohet dhe nëse është zbatuar me përpikmëri, atëherë subjektit i rimbursohet taksa e paguar mbi nivelin minimal të përcaktuar me ligj.

⁶ Sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 22/2018 “Për strehimin social”;

⁷ Sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;

Përfundime:

Përfundohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”. Përfundohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

⁸ Përfundohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuar për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përfundimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.

⁹ Nga pagesa e kësaj takse përfundohen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

¹⁰ Përfundohen nga pagesa e kësaj takse ndërtimi i objekteve të reja, ndërtesat në pronësi ose në përdorim të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ose të personave juridikë të themeluar prej tij të regjistruara pranë organeve kompetente shtetërore, në rastet kur ato përdoren pa qëllim fitimi për ushtrimin e besimit, drejtimin dhe administrimin fetar, veprimtarinë fetare, humanitare e bamirëse,

formimin e klerikëve, mësimin e teologjisë dhe shkencave të tjera fetare, si dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi.¹¹

Nga pagesa e kësaj takse përjashtohen objektet pronë e paluajtshme e shtetit dhe të destinuara për ushtrimin e funksioneve publike, me pronësi publike, të ndërtuara me financime nga buxheti i shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo nga investimet e enteve publike. Sipas Ligjit 82/2025 “Për disa shtesa dhe ndryshim në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e ngarkuar për planifikimin dhe llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe tarifave të tjera të bashkëlidhura është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, e cila përcjell informacionin tek Drejtoria për Taksat dhe Tarifat Vendore.

⁸ Me Aktin Normativ Nr. 3, datë 2.10.2019 është shtuar përjashtimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë:

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

⁹ AKT NORMATIV Nr. 19, datë 23.4.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

¹⁰ Ligji nr.10056, dt 22.1.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.

¹¹ Shtuar me Aktin Normativ Nr. 19, datë 23.04.2020.

Të gjithë investitorët (individë, persona fizik, OJF, subjektet ndërtuese, etj) do të pajisen me lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Shkodër, vetëm pasi:

- të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe detyrimet përkatëse për tarifën e pastrimit, për kantierin e ndërtimit;
- për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, përveç shlyerjes së detyrimeve të mësipërme, duhet edhe të kenë nënshkruar kontratën me Bashkinë Shkodër për fondin e banesave sociale.

Të gjithë individët, persona fizik, OJF, subjektet ndërtuese, etj, do të pajisen me deklaratën paraprake të punimeve pranë Bashkisë Shkodër, vetëm pasi të kenë paguar tarifën e pastrimit për kantierin e ndërtimit.

I.5. Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:

Garancia financiare: Në mbështetje të pikës 10 te VKM-se Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit

duhet të depozitohet një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

Njësitë e qeverisjes vendore, më konkretisht Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr. 575, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga Bashkia, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provojë se mbetjet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4, 5 dhe 6, të VKM Nr. 575 në landfillin ose në vend-depozitim të përkohshëm të përcaktuar nga Bashkia. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, Bashkia konfiskon garancinë financiare.

Strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe përlllogaritjen: Struktura e ngarkuar për planifikimin dhe llogaritjen e pagesës së garancisë financiare është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Struktura e ngarkuar: Struktura e ngarkuar për vjeljen e detyrimit është Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifat Vendore pranë Bashkisë Shkodër.

I.6. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë *për ndërtesat* është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë *për pasuritë e tjera të paluajtshme* është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Tabelë 8. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Shkodër
Ndërtesa banimi	Lekë/m ²	300
Ndërtesa për tregëti dhe shërbime, përfshi dhe zyra	Lekë/m ²	700
Ndërtesa të tjera	Lekë/m ²	500

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Mënyra e mbledhjes: Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), e cila në rolin e agentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Shkodër, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Ngarkohet Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifat Vendore pranë Bashkisë të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ish-ZRPP).

Përjashtime:

¹²Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të Kishës Katolike ose të enteve të saj, të përdorura për ushtrimin e kultit, drejtimin dhe administrimin kishtar, veprimtarinë baritore, humanitare dhe bamirëse, formimin e meshtarëve dhe të rregulltarëve, si dhe për banimin e mbarështuesve të kultit dhe të personelit fetar dhe laik në shërbim të Kishës do të përjashtohen nga pagimi i taksës së trashëgimisë ose të kalimit të pasurisë, në rastin e dhurimeve mes Kishës Katolike dhe enteve të saj, ose mes vetë enteve të parashikuara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje. Destinacioni i pasurive të sipërpërmendura do të provohet me aktet noteriale përkatëse.

¹³Taksa e trashëgimisë ose e kalimit të pasurisë në procesin e regjistrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat i dhurohen Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ose kur ato kalojnë mes entiteteve të vetë Komunitetit Mysliman.

¹² Ligj nr. 9865, datë 31.01.2008 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për disa çështje ekonomike dhe tatimore”.

¹³ Ligj nr. 10 056, datë 22.01.2009 Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”

I.7. Taksa e tabelës

Taksa e tabelës është një taksë vendore që zbatohet ndaj subjekteve taksapagues biznes që përdorin tabela për identifikim apo reklamim të veprimtarisë së tyre. Qëllimi i kësaj takse është të rregullojë dhe taksojë përdorimin e hapësirave vizuale për identifikimin apo promovimin e veprimtarive ekonomike dhe tregtare.

Përkufizimi	Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.
Kategoritë	<ul style="list-style-type: none">• Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve.• Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.• Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat

	<p>tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.
Baza e taksës	Sipërfaqja në m ² (metër katrorë)

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

2. Për qëllime të zbatimit të taksës, tabelat kategorizohen në:

a) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë (tabela me sipërfaqen më të madhe).

b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

c) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

ç) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi.

Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.

Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabelle. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.

Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabelle identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabelle.

Tabelë 9. Taksa e tabelës

Nr.	Llojet e tabelave	Njësia		
I	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)			
a	deri në 2 m ²	Lekë/m ² /vit	0	
b	mbi 2 m ² deri 10 m ²			
	1	e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	10,000
	2	me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	15,000
	3	elektronike	Lekë/m ² /vit	20,000
c	mbi 10 m ² deri 20 m ²			

	1	e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	8,500
	2	me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	12,750
	3	elektronike	Lekë/m ² /vit	17,000
ç	mbi 20 m ² deri 40 m ²			
	1	e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	5,500
	2	me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	8,250
	3	elektronike	Lekë/m ² /vit	11,000
d	mbi 40 m ²			
	1	e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	4,000
	2	me ndriçim të thjeshtë	Lekë/m ² /vit	6,000
	3	elektronike	Lekë/m ² /vit	8,000
II	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim			
a	Tabela identifikuese		Lekë/m ² /vit	120
III	Tabela për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35m ²			
a	e thjeshtë (me/pa ndriçim)		Lekë/m ² /vit	22,500
b	elektronike		Lekë/m ² /vit	45,000
IV	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.			
a	Të të gjitha llojeve dhe përmasave		Lekë/m ² /ditë	1,000

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m² do t'i shtohet, shuma e taksës e llogaritur për diferencën e sipërfaqes së mbi 10 m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës.

P.sh., për një tabelë të thjeshtë 15 m², shuma e taksës vjetore do të llogaritet;
 $(10 \text{ m}^2 \times 15,000 \text{ Lekë}) + (5 \text{ m}^2 \times 12,750 \text{ Lekë}) = 150,000 + 63,750 = 213,750 \text{ Lekë në vit (ose } 17,812 \text{ Lekë/muaj)}$.

E njëjta llogjikë llogaritjeje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m² dhe mbi 40 m².

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë. Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m², do të konsiderohet sikur është 35 m² dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m².

Në kategorinë e reklamës konsiderohet çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në pamje jo ballore, në tarraca, lozhë, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përmbajtje me qëllim reklamimi për vete ose të tretë.

Detyrimi dhe kështet e pagesës: Detyrimi për Taksën e Tabelës për Kategoritë 1, 2 dhe 3 është vjetor.

- Për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës 30 qershor, detyrimi llogaritet

dhe paguhet menjëherë për periudhën nga data e deklarimit. (nga data e deklarimit deri në përfundim të vitit fiskal)

- Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji korrent që subjekti regjistrohet pranë QKR dhe paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin, nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKR.
- Për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Shkodër.
- Për “kategorinë 4” detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Shkodër dhe paguhet menjëherë.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe përlllogaritjen: Struktura e ngarkuar për planifikimin, matjen e sipërfaqes dhe llogaritjen e pagesës për taksën e tabelës është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Struktura e ngarkuar për lëshimin e faturës dhe vjeljen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Shkodër.

Për Kategorinë “Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike”:

Struktura/Drejtoria përgjegjëse për Kontrollin e Zhvillimit të Territorit ngarkohet për shqyrtimin e kërkesës nga ana e subjektit, si dhe për hartimin e dokumentacionit të plotë të marrjes së lejes për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e sipërfaqeve objekt taksimi. Kjo Drejtori njofton në mënyrë periodike Drejtorinë Taksave dhe Tarifave Vendore në lidhje me të gjitha ndryshimet në vend-ndodhje, llojin e tabelave dhe sipërfaqe (shitesa apo pakësime) që janë objekt i kësaj takse.

Taksapaguesi, i cili nuk paguan, brenda afatit të parashikuar, shumën e detyrimit tatimor, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Kapitulli II: Taksat e ndara

“**Taksë ose tatim i ndarë**” është një taksë kombëtare ose tatim i përcaktuar sipas ligjit për procedurat tatimore ose ligjeve të veçanta tatimore, të ardhurat respektive prej të cilave ndahen, plotësisht ose pjesërisht, me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

II.1 Taksa e mjeteve të përdorura të transportit.

Baza e taksës: Lloji i mjetit të transportit rrugor është bazë për taksën e cila përllogaritet si vijon: Cilindrata në cm^3 x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, dhe konkretisht Drejtoritë Rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, 25% (njëzet e pesë për qind) e të ardhurave vjetore nga kjo taksë, i kalojnë si të ardhura buxhetit të qeverisjes vendore.

II.2 Taksa e rentës minerare.

Baza e taksës: Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Degët e doganave në rrethe (Drejtoritë Rajonale të Doganave) ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve (Drejtoritë Rajonale të Tatimeve) ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

5% (pesë për qind) e të ardhurave nga renta minerare i takojnë Bashkisë Shkodër, ku zhvillohet veprimtaria.

II.3 Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Baza e taksës: Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë si taksë të ndarë, 2% (dy për qind) e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Drejtoritë Rajonale të Tatimeve janë përgjegjëse për arkëtimin. Ministria e Financave shpërndan të ardhurën takuese për Bashkinë Shkodër.

Kapitulli III: Tarifat vendore

Bashkia Shkodër vendos tarifa për shërbimet që ofron apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë. Niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik. Bashkia Shkodër mund të vendosë tarifa vetëm për shërbimet publike, konsumi ose përfitimi i të cilave, në parim, është i matshëm për përdoruesit apo përfituesit, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballeshme nga të gjithë.

Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në ligje të veçanta, Këshilli Bashkiak përcakton nivelet e tarifave vendore.

Ndër tarifat kryesore me ndikim në buxhetin e njësisë vendore, renditen:

- Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve,

- Tarifa për ndriçimin,
- Tarifa për gjelbërimin,
- Tarifa për zënien e hapësirave publike,
- Tarifa e parkimit të automjeteve.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë.

Niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa vetëm për shërbimet publike, konsumi ose përfitimi i të cilave, në parim, është i matshëm për përdoruesit apo përfituesit, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përbalueshme nga të gjithë. Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët e:

- Llojit të shërbimit, bazës së taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

III.1 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve është një tarifë vendore që u ngarkohet individëve dhe subjekteve ekonomike për të mbuluar kostot që lidhen me ofrimin e shërbimit të pastrimit, e që zakonisht përfshin grumbullimin, transportin dhe depozitimin e mbetjeve të ngurta urbane.

Tarifa u aplikohet:

- (i) Familjeve,
- (ii) Bizneseve dhe institucioneve;

këto te fundit klasifikuar sipas nivelit të xhiros vjetore së aktivitetit.

Përkufizimi: “Tarifë e pastrimit dhe largimit të mbeturinave” është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Shkodër dhe njësive të saj administrative.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tabelë 3. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjet

Nr.	Kategoritë	Niveli i Tarifës
		Familje Lekë/vit

I	FAMILJARET (për familje)	
I.1	Njësia Administrative Shkodër	3,450
	Njësitë e tjera Administrative	
	Postribë	1,950
	Pult	1,450
	Shosh	1,450
	Shalë	1,450
I.2	Guri i Zi	1,950
	Bërdicë	1,950
	Dajç	1,950
	Velipojë	1,950
	Ana e Malit	1,950
	Rrethina	1,950

Tabelë 4. Tarifë pastrimi për institucione

II	Tarifë pastrimi për institucione	Njësia	Tarifa
	Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetësore, sportive, etj.	Lekë/vit/njësi	8,000

Tabelë 5. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për bizneset

III	BIZNESI	Njësia	Deri në 8 milion lekë xhiro në vit	Mbi 8 milion lekë xhiro në vit
1	Njësi tregtare dhe shërbimi në Njësinë Administrative Shkodër dhe Velipojë Plazh	Lekë/vit/njësi	13,000	33,000
1.1	Njësi tregtare, me sipërfaqe ndërtese nga 501-1000 m ²	Lekë/vit/njësi	13,000	50,000
1.2	Njësi tregtare, me sipërfaqe ndërtese mbi 1000 m ²	Lekë/vit/njësi	13,000	63,000
1.3	Bar/Restorant/Rostiçeri, me sipërfaqe ndërtese nga 301-500 m ²	Lekë/vit/njësi	16,000	43,000
1.4	Bar/Restorant/Rostiçeri, me sipërfaqe ndërtese mbi 500 m ²	Lekë/vit/njësi	20,000	50,000
1.5	Njësi tregtare dhe shërbimi me kontratë për trajtimin e mbetjeve spitalore.	Lekë/vit/njësi	6,000	25,000
1.6	Njësi shërbimi (këpucar, biçiklist, berber)	Lekë/vit/njësi	8,000	
2	Njësi tregtare dhe shërbimi në Njësitë Administrative Postribë, Pult, Shosh,	Lekë/vit/njësi	8,000	33,000

	Shalë, Guri i Zi, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Ana e Malit, Rrethina			
2.1	Bar/Restorant/Rostiçeri, me sipërfaqe ndërtese nga 301-500 m ²	Lekë/vit/njësi	10,000	43,000
2.2	Bar/Restorant/Rostiçeri, me sipërfaqe ndërtese mbi 500 m ²	Lekë/vit/njësi	12,000	43,000
2.3	Njësi tregtare dhe shërbimi me kontratë për trajtimin e mbetjeve spitalore.	Lekë/vit/njësi	6,000	25,000
3	Njësi tregtare për tregtim karburanti	Lekë/vit/njësi	48,000	
4	Njësi prodhimi			
4.1	Njësi prodhimi në Njësinë Administrative Shkodër	Lekë/vit/njësi	13,000	63,000
4.2	Njësi prodhimi në Njësitë e tjera Administrative	Lekë/vit/njësi	8,000	33,000
5	SUBJEKTE NDËRTIMI			
5.1	Subjekte ndërtuese për selinë administrative Bashkia Shkodër dhe kantier ndërtimi, adresë sekondare për subjekte me seli jashtë territorit të Bashkisë Shkodër	Lekë/vit/njësi	73,000	73,000
6.	Investitor/Individ/Persona fizik/OJF/Subjekte ndërtimi sipas investimit/deklaratës paraprake të punimeve dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit për vlera investimi/preventivi:			
6.1	deri në 5,000,000 Lekë	Lekë/kantier/vit		20,000
6.2	nga 5,000,001-15,000,000 Lekë	Lekë/kantier/vit		40,000
6.3	nga 15,000,001-25,000,000 Lekë	Lekë/kantier/vit		60,000
6.4	nga 25,000,001–50,000,000 Lekë	Lekë/kantier/vit		80,000
6.5	nga 50,000,001–100,000, 000 Lekë	Lekë/kantier/vit		100,000
6.6	nga 100,000,001–200,000,000 Lekë	Lekë/kantier/vit		150,000
6.7	mbi 200, 000, 000 Lekë	Lekë/kantier/vit		200,000
7	Shoqata, fondacione, ente të ndryshme shtetërore, organizata joqeveritar			
7.1	Institucione Administrative Publike	Lekë/vit/njësi	8,000	
7.2	Organizata të tjera jofitimprurëse	Lekë/vit/njësi	6,000	
8	PROFESIONE TE LIRA			
	Profesione të lira (avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i	Lekë/vit/njësi	8,000	33,000

	regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë).			
9	AMBULANT			
	Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi , tregtia ambulante në tregje publike dhe private.	Lekë/vit/njësi	5,500	

Sqarime:

Xhiro vjetore bazohet mbi qarkullimin total të subjektit, për një vit fiskal.

Kategorizimi i subjekteve për efekt tarifimi do të bëhet në bazë të xhiros vjetore të vitit paraardhës, duke përfshirë xhiron totale të të gjitha adresave pavarësisht vendndodhjes, marrë nga Drejtoria e Tatimeve ose bazuar në vërtetimin e xhiros që e ka detyrim për të paraqitur vetë subjekti, kur i kërkohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Subjektet që regjistrohen për herë të parë gjatë vitit korrent do të kategorizohen në kategorinë deri në 8 milion lekë xhiro në vit, për efekt të vlerësimit dhe pagesës së detyrimeve vendore.

Subjektet që kalojnë në statusin “aktiv” pas një periudhe të gjatë pasiviteti (me status “i pezulluar”) më shumë se një viti fiskal, do të vlerësohen në kategorinë deri në 8 milion lekë xhiro në vit, për efekt të pagesës së detyrimeve vendore.

Subjektet që kërkojnë çregjistrim gjatë vitit fiskal duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vërtetim xhiro të vitit korrent, për efekt të vlerësimit dhe pagesës së detyrimeve vendore.

Subjektet që hapin adresa sekondare në territorin e Bashkisë Shkodër duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vërtetim xhiro të vitit paraardhës, për të gjitha adresat që disponojnë të marra së bashku.

Për të gjithë subjektet që kanë ndryshim pragu të xhiros vjetore gjatë vitit 2026 bëhet rivlerësim i kategorizimit në vitin 2027, për efekt të vitit ushtrimor paraardhës. Kjo procedurë do të ndiqet në vijimësi për të gjitha periudhat pasardhëse ushtrimore.

Subjektet që i janë nënshtruar rivlerësimit dhe janë me tepricë kreditore, vlera e paguar më tepër do të mbartet për vitet pasardhëse.

Subjektet që i janë nënshtruar rivlerësimit dhe janë me tepricë debitore, vlera e detyrimit ka afat pagese 30 Qershor të vitit korrent.

Baza e tarifës:

Është vlera në Lekë sipas kategorive e cila duhet të mbulojë koston e shërbimit.

Detyrimi për pagesën: Detyrimi për Tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave është vjetor.

Kategoria I. “Familjarët”: Detyrimi për familjarët shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë ose vetëm për tarifat vendore, pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime - Qarku Shkodër sh.a., në cilësinë e agjentit tatimor.

Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime - Qarku Shkodër sh.a., faturohen direkt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkinë Shkodër, me bazë vjetore. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së pastrimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kategoria II, III.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria për Taksat dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, në sportelet e Posta Shqiptare sh.a dhe sportelet e Unionit Financiar Tiranë, brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB. Njësitë tregtare dhe shërbimi me kontratë për trajtimin e mbetjeve spitalore, duhet të paraqesin kontratën e noterizuar për trajtimin e mbetjeve spitalore për vitin fiskal.

Për të gjitha kategoritë: Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës :

Për Kategoria I “Familjarët”, struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit, është Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime - Qarku Shkodër sh.a. duke përfituar 2% (dy për qind) të të ardhurave të arkëtuara nga tarifa. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ndjek, monitoron e raporton realizimin e të ardhurës.

Kategoria III. “Biznesi”, Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit, është Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifat Vendore.

III.2 Tarifa e ndriçimit

Përkufizimi: Tarifa e ndriçimit është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik

apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Shkodër dhe njësisive të saj administrative.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së ndriçimit janë të shprehura si më poshtë:

Tabelë 6. Tarifë ndriçimi për familje

	¹⁵ Tarifë ndriçimi për familje	Njësia	Tarifa
I.1	Familje NjA Shkodër (për familje) dhe Velipojë Plazh	Lekë/vit/familje	1,500
I.2	Njësia administrative Velipojë, Dajç, Bërdicë, Rrethina, Guri Zi, Postribë, Ana Malit	Lekë/vit/familje	720

Tabelë 7. Tarifë ndriçimi për institucione

	¹⁶ Tarifë ndriçimi për institucione	Njësia	Tarifa
II	Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetësore, sportive, etj. dhe ofj.	Lekë/vit/njësi	3.250

¹⁵ Sipas analizës së kostos realizuar nga Bashkia Shkodër

¹⁶ Sipas analizës së kostos realizuar nga Bashkia Shkodër

Tabelë 8. Tarifë ndriçimi për biznesin

III	¹⁷ BIZNESI	Njësia	Deri në 8 milion lekë xhiro në vit	Mbi 8 milion lekë xhiro në vit
III.1.a	Subjekte tregtare dhe shërbimi, në Njësinë Administrative Shkodër, Plazhet Velipoje/Baks Rrjoll	Lekë/vit/njësi	2.600	6,500
III.1.b	Subjekte tregtare dhe shërbimi në Njësitë Administrative Postribë, Guri i Zi, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Ana e Malit, Rrethina	Lekë/vit/njësi	1.300	2.600
III.2.a	Njësi tregtare për tregtim karburanti në Njësinë Administrative Shkodër, Plazhet Velipoje/Baks Rrjoll)	Lekë/vit/njësi	9.000	9.000
III.2.b	Njësi tregtare për tregtim karburanti në Njësitë Administrative Postribë, Guri i Zi, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Ana e Malit, Rrethina	Lekë/vit/njësi	3.250	3.250
III.3.1	Profesione të lira; Njësia administrative Shkodër, Plazh Velipojë	Lekë/vit/njësi	2.600	6,500
III.3.2	Profesione të lira;	Lekë/vit/njësi	1.300	2.600

	Njësia administrative Postrinë, Guri i Zi, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Ana e Malit, Rrethina			
III.4.1	Njësi prodhimi; Në Njësinë Administrative Shkodër Plazhet Velipojë/ Baks Rrjoll,	Lekë/vit/njësi	2.600	6.500
III.4.2	Njësi prodhimi; në Njësitë Administrative Postrinë, Guri i Zi, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Ana e Malit, Rrethina	Lekë/vit/njësi	1.300	2.600
III.5	Subjekte ndërtuese për selinë administrative Bashkia Shkodër dhe kantier ndërtimi adresë sekondare për subjekte me seli jashtë territorit të Bashkisë Shkodër.	Lekë/vit/njësi	7,800	7,800

¹⁷ Sipas analizës së kostos realizuar nga Bashkia Shkodër.

Sqarime:

Xhiro vjetore bazohet mbi qarkullimin total të subjektit.

Kategorizimi i subjekteve për efekt tarifimi do të bëhet në bazë të xhiros vjetore të vitit paraardhës, xhiro totale e të gjitha adresave pavarësisht vendndodhjes, marrë nga Drejtoria e Tatimeve ose bazuar në vërtetimin e xhiros që e ka detyrim për të paraqitur vetë subjekti, kur i kërkohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Subjektet që regjistrohen për herë të parë gjatë vitit korrent do të kategorizohen në kategorinë deri në 8 milion lekë xhiro në vit.

Subjektet që kalojnë në statusin aktiv pas më shumë se një viti fiskal kategorizohen në kategorinë deri në 8 milion lekë xhiro në vit.

Subjektet që kërkojnë rregjistrim gjatë vitit fiskal duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vertetim xhiro të vitit korrent.

Subjektet që hapin adresa sekondare në territorin e Bashkisë Shkodër duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vertetim xhiro të vitit paraardhës.

Për të gjithë subjektet që kanë ndryshim pragu të xhiros vjetore bëhet rivlerësim i kategorizimit duke filluar nga viti 2027 për efekt vitin ushtimor paraardhës.

Subjektet që i janë nënshtruar rivlerësimit dhe janë me teprice kreditore, vlera e paguar më tepër do të mbartet për vitet pasardhëse. Subjektet që i janë nënshtruar rivlerësimit dhe janë me teprice debitore, vlera e detyrimit ka afat pagese 30 Qershor të vitit korrent.

Baza e tarifës: Është vlera në Lekë sipas kategorive e cila duhet të mbulojë koston e shërbimit.

Niveli i tarifës së ndriçimit: Detyrimi për Tarifën e ndriçimit është vjetor.

Kategoria I. “Familjarët”: Detyrimi për familjarët shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë ose vetëm për tarifat vendore, pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime - Qarku Shkodër sh.a., në cilësinë e agjentit tatimor.

Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin faturohen direkt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkinë Shkodër, me bazë vjetore. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së pastrimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kategoritë II,III:

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria për Taksat dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, në sportelet e Posta Shqiptare sh.a dhe sportelet e Unionit Financiar Tiranë, brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB.

Për të gjitha kategoritë:

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar më pas atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës:

Për Kategoria I “Familjarët”, struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndriçimit, është Ujësjellës Kanalizime sh.a Shkodër, duke përfituar 2% të të ardhurave të arkëtuara nga tarifa. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ndjek, monitoron e raporton realizimin e të ardhurës.

Kategoria II “Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetësore, sportive, etj. dhe OJF” dhe III. “Biznesi”, struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndriçimit është Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifat Vendore.

¹⁸ Sipas VKM 144/2020

III.3 Tarifa e gjelbërimit

Përkufizimi: Tarifa e gjelbërimit është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Shkodër dhe njësisive të saj administrative.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së gjelbërimit, janë të shprehura si më poshtë:

Tabelë 9. Tarifë gjelbërimit për familje

	Tarifë gjelbërimit për familje	Njësia	Tarifa
I	Familje Nj.A. Shkodër (për familje)	Lekë/vit/familje	600

Tabelë 10. Tarifë gjelbërimit për institucionet

	Tarifë gjelbërimit për institucione	Njësia	Tarifa
II	Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetësore, sportive, etj. dhe Ojf.	Lekë/vit/njësi	2,500

Tabelë 11. Tarifë gjelbërimit për biznesin

III	Tarifë gjelbërimit për biznesin	Njësia	Deri në 8 milion lekë xhiro në vit	Mbi 8 milion lekë xhiro në vit
	Subjekte tregtare dhe shërbimi			
III.1	Njësia administrative Shkodër, Plazhet Velipoje/Baks Rrjoll	Lekë/vit/njësi	2,000	5,000
III.2	Pikë Karburanti; Njësia administrative Shkodër, Plazhet Velipoje/Baks Rrjoll	Lekë/vit/njësi	7,000	
	Profesione të lira			
III.3	Njësia administrative Shkodër, Plazhet Velipoje/Baks Rrjoll	Lekë/vit/njësi	2,000	5,000
	Subjekte prodhimi, përpunimi, etj.			
III.4	Njësia administrative Shkodër, Plazhet Velipoje/Baks Rrjoll	Lekë/vit/njësi	2,000	5,000
	Shërbim transporti			
III.5	Njësia administrative Shkodër, Plazhet Velipoje/ Baks Rrjoll	Lekë/vit/njësi	2,000	5,000
III.6	¹⁹ Subjekte ndërtuese për selinë administrative Bashkia Shkodër dhe kantier ndërtimi adresë sekondare për subjekte me seli jashtë territorit të Bashkisë Shkodër	Lekë/vit/njësi	15,000	15,000

¹⁹ Sipas VKM 144/2020

Sqarime:

Xhiro vjetore bazohet mbi qarkullimin total të subjektit.

Kategorizimi i subjekteve për efekt tarifimi do të bëhet në bazë të xhiros vjetore të vitit paraardhës, xhiro totale e të gjitha adresave pavarësisht vendndodhjes, marrë nga Drejtoria e Tatimeve ose bazuar në vërtetimin e xhiros që e ka detyrim për të paraqitur vetë

subjekti, kur i kërkohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Subjektet që regjistrohen për herë të parë gjatë vitit korrent do të kategorizohen në kategorinë deri në 8 milion lekë xhiro në vit.

Subjektet që kalojnë në statusin aktiv pas më shumë se një viti fiskal kategorizohen në kategorinë deri në 8 milion lekë xhiro në vit.

Subjektet që kërkojnë çrregjistrim gjatë vitit fiskal duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vertetim xhiro të vitit korrent.

Subjektet që hapin adresa sekondare në territorin e Bashkisë Shkodër duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore vertetim xhiro të vitit paraardhës.

Për të gjithë subjektet që kanë ndryshim pragu të xhiros vjetore bëhet rivlerësim i kategorizimit duke filluar nga viti 2027 për efekt vitin ushtimor paraardhës.

Subjektet që i janë nënshtruar rivlerësimit dhe janë me teprice kreditore, vlera e paguar më tepër do të mbartet për vitet pasardhëse.

Subjektet që i janë nënshtruar rivlerësimit dhe janë me teprice debitore, vlera e detyrimit ka afat pagese 30 Qershor të vitit korrent.

Baza e tarifës:

Është vlera në Lekë sipas kategorive e cila duhet të mbulojë koston e shërbimit.

Niveli i tarifës së gjelbërimit: Detyrimi për Tarifën e gjelbërimit është vjetor.

Kategoria I “Familjarët”:

Detyrimi për familjarët shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë ose, vetëm për tarifat vendore, pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime - Qarku Shkodër sh.a., në cilësinë e agjentit tatimor.

Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin faturohen direkt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkinë Shkodër, me bazë vjetore. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së pastrimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kategoritë II, III:

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria për Taksat dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, ne sportelete Posta Shqiptare sh.a dhe sportelet e Unionit Financiar Tiranë, brenda datës 30 qershor të vitit fiskal. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Përrjashtime nga tarifa e pastrimit, tarifa e ndriçimit dhe tarifa e gjelbërimit për kategoritë e ndryshme:

Përrjashtohen nga tarifaf vendore (tarifa e pastrimit, tarifa e ndriçimit dhe tarifa e gjelbërimit), për një vit kalendarik, nga momenti i paisjes me NIPT, bizneset që janë përfitues të Programit Shtetëror të Vetëpunësimit sipas VKM nr. 348, datë 29.04.2020.

Për të përfituar këtë lehtësi biznesi duhet të paraqesë një vërtetim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria Rajonale Shkodër që është shpallur fitues i Programit Shtetëror të Vetëpunësimit dhe është trajtuar me grant nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria Rajonale Shkodër.

Tabelë 12. Përrjashtimet për individët dhe familjet nga tarifa e pastrimit, tarifa e ndriçimit dhe tarifa e gjelbërimit.

Nr.	Përrjashtime	Niveli
1	Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes)	50% të vlerës
2	Përfituesit e ndihmës ekonomike	0
3	Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/ bashkëshortes);	50% të vlerës
4	Kryefamiljarët gra me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç);	50% të vlerës

- a) Nënkatëgoritë 1-3 përrjashtohen apo lehtësohen nga pagesa e tarifës së pastrimit (vetëm në rastet kur janë familjarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim mbi moshën 22 vjeç) Drejtoria përrgjegjëse për Taksat dhe Tarifaf Vendore verifikon pranë Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike të gjitha aplikimet e familjarëve për lehtësi fiskale, sipas dokumentacionit:
 - Statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit, librezën për paraplegjik e tetraplegjik, përfitimin e ndihmës ekonomike.
 - Në momentin e aplikimit kryefamiljarët pensionistë paraqesin librezën e pensionit.
- Listaf e përfituesve administrohen nga Drejtoria përrgjegjëse për Taksat dhe Tarifaf Vendore, që rivlerëson detyrimin dhe sipas rastit, dërgon informacionin për zbatim tek agjenti tatimor.
- b) Në katëgorinë III “**Biznesi**”, fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” përrjashtohen nga tarifa vendore për biznesin.
- c) Përrjashtohen nga tarifa vendore: Institucionet, subjektet dhe organizatat në pronësi dhe varësi të Bashkisë Shkodër; Institucionet që shpenzimet operative ia mbulon vetë Bashkia Shkodër; Komunitetet fetare të njohura me ligj.
- d) Përrjashtohen nga tarifaf vendore të pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit subjektet për subjektet me xhiro 0 - 8 milion lekë që ushtrojnë aktivitetë në fushën e artit me aktivitet kryesor të regjistruar në QKB (Muzikant, Studio Muzike, Piktur, Studio Pikturë, Skulptur, Këngëtar dhe Shtëpi botuese).

- e) Përrjashtim nga tarifaf vendore të pastrimit, ndrçimit dhe gjelbërimit subjektet për subjektet me xhiro 0 - 8 milion lekë që kanë në përdorim ose në pronësi terrene sportive fusha futbollli, mini futbollli, tenisi, volejbollli, basketbollli
- f) Përrjashtim nga tarifaf vendore të pastrimit, ndrçimit dhe gjelbërimit për subjektet me xhiro 0 - 8 milion lekë, në pronësi të grave kryefamiljare të cilaf kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 22 vjeç.
- g) Përrjashtim nga tarifaf vendore të pastrimit, ndrçimit dhe gjelbërimit për subjektet me xhiro 0 - 8 milion lekë si përrfitues të granteve të bashkisë Shkodër, për një periudhë 2 vjeçare dhe AKPA (Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive) për një periudhë 1 vjeçare
- h) Përrjashtim 50 % nga tarifaf vendore të pastrimit, ndrçimit dhe gjelbërimit për subjektet me xhiro 0 - 8 milion lekë për subjektet që punësojnë për 12 Muaj, pa shkeputje, përrsona nga komuniteti rom dhe egjyptian.

III.4 Tarifa të shërbimit administrativ të Bashkisë Shkodër

III.4.1. Tarifa të Drejtorisë së Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Bazuar në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, si dhe VKM nr.430, datë 11.7.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-leje)”, duke bërë ndarjen në dy kategori të ndryshme, për ndërtime individuale dhe për shoqëri ndërtime, ndarjen në bazë të tipologjisë së lejeve që ofrohen nga Bashkia Shkodër, si dhe ndryshimin e tarifave sipas tabelës bashkëlidhur. Referuar ndryshimeve të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, konkretisht VKM nr. 457, datë 29.06.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, Të këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar”, ku pasqyrohen ndryshime në neni 23, pika 3.

Gjithashtu bazuar në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, neni 42, si dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar, neni 27 “Çertifikata e përdorimit”, në përfundim të procesit të zhvillimit aplikuesi paraqet në Bashkinë Shkodër kërkesën për t’u pajisur me certifikatë përdorimi, së bashku me procesverbalin e kolaudimit dhe dokumentacionin shoqërues, përfshirë deklaratën teknike se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi. Aplikimi nga ana e subjektit, realizohet nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, përrmes portalit e-Albania (e-leje). Në përfundimit të procesit të çertifikimit, subjekti duhet të likuidojë tarifën për çertifikatë përdorimi.

Tabela 20: Tarifa për aplikimi për shqyrtim kërkesë

TARIFË APLIKIMI PËR SHQYRTIM KËRKESE				
Nr.	BASHKIA	SUBJEKTI	NJËSIA MATËSE	TARIFA (Lekë)
1	SHKODËR	Tarifë aplikimi për Leje Zhvillimi		

2		Për ndërtime individuale	Lekë	3,000
3		Për shoqëri ndërtimi	Lekë	5,000
4		Tarifë aplikimi për Leje Ndërtimi		
5		Për ndërtime individuale	Lekë	5,000
6		Për shoqëri ndërtimi	Lekë	10,000
7		Tarifë aplikimi për ndryshim projekti gjatë ndërtimit		
8		Për ndërtime individuale	Lekë	3,000
9		Për shoqëri ndërtimi	Lekë	5,000
10		Tarife aplikimi për leje për shtyerje afati	Lekë	3,000
11		Tarifë aplikimi për leje ndryshim funksioni	Lekë	5,000
12		Tarifë aplikimi për leje për prishje objekti	Lekë	5,000
13		Tarifë aplikimi për leje infrastrukture	Lekë	10,000

Drejtorja e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit përcakton objektet, sipërfaqen, numrin e kateve etj, e cila hap pas hapi përcjell informacionin dhe llogaritjen e detyrimit tek Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifave Vendore.

Tarifat mbulohen nga subjekti ndërtues që përfiton shërbimin.

Struktura e ngarkuar për përllogaritjen dhe vjeljen e tarifës së shërbimeve është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Struktura e ngarkuar për faturimin (lëshimin e faturës) e tarifës së shërbimeve është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Drejtorja e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit nuk ofron shërbimin përkatës pa u kryer shlyerja e detyrimit.

Tabelë 21. Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokësore

	Tarifë për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	Njësia	Vlerë
1	Për linjat ajrore	Lekë/km/vit	2.000
2	Për linjat nëntokësore	Lekë/km/vit	1.000

Për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informatik, tarifave vendore vendosen vetëm në rastin kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukture, si: tubacione, kanale etj., të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore. Të ardhurat e siguruara prej tyre shërbejnë për përbalimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit në përdorim.

Për tarifën për linjat ajrore dhe nëntokësore Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit kryen verifikimet përkatëse dhe përcjell informacionin pranë Drejtorisë përgjegjëse për Taksat dhe Tarifave Vendore duke përcaktuar subjektin, km (gjatësinë) e linjës dhe vlerën e detyrimit.

Drejtorja e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit nuk ofron shërbimin përkatës pa u kryer shlyerja e detyrimit.

Tabela 22: Tarifa për certifikatë përdorimi

TARIFË PËR ÇERTIFIKATË PËRDORIMI				
Nr.	BASHKIA	SUBJEKTI	NJËSIA MATËSE	TARIFA (Lekë)
1	BASHKIA SHKODER	Tarifë për certifikatë përdorimi	Lekë/m ²	50

Tarifë për Akt Kontrollin

Bazuar në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, neni 42, si dhe referuar ndryshimeve të VKM nr.408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, konkretisht neni 27/1 “Mbikëqyrja e punimeve”, është përfshirë si detyrim ligjor konfirmimi i akteve të kontrollit sipas gjendjes fatike të objektit. Verifikimi dhe konfirmimi i akteve të kontrollit është një shërbim që ofron Bashkia Shkodër.

Vendosja e tarifave përkatëse është përcaktuar bazuar në vlerësimin e përafërt të kostos, ku përfshihen paga e sigurime të punonjësve që do të merren me verifikimin e konformitetit të akteve të kontrollit në terren, pajisje për verifikimin e konformitetit të akteve të kontrollit, transport/karburant.

Qëllimi i shërbimit është sigurimi i një procesi të rregullt ndërtimor duke arritur trajtimin e një problematike apo shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit që në fillimet e veta, pa lejuar vazhdimin e ndërtimit me shkelje dhe duke mbrojtur interesat e ligjshme të pronarëve të truallit, investitorit, kufitarëve apo personave të tretë.

AKT KONTROLLI				
Nr.	BASHKIA	SUBJEKTI	NJËSIA MATËSE	TARIFA (Lekë)
1		Akt kontroll ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues		
		Për objekte deri në 3 kate	Lekë	5,000
		Për objekte mbi 3 kate	Lekë	10,000
2		Akt kontroll përfundimi i themeleve dhe kuota 0;		
		Për objekte deri në 3 kate	Lekë	5,000
		Për objekte mbi 3 kate	Lekë	10,000
3	SHKODER	Akt kontroll përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin;	Lekë/kat	5,000
4		Akt kontroll përfundimi i fasadave, rifiniturave dhe sistemit të jashtëm në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë dhe vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese.		
		Për objekte deri në 3 kate	Lekë	5,000
		Për objekte mbi 3 kate	Lekë	10,000

Shënim: Këto tarifa shtohen në paketën fiskale në zbatim të detyrimeve ligjore për konfirmimin e akt kontrolleve bazuar në nenin 27/1, të VKM 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar.

III.4.2 Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, dhënien e lejeve për ushtrim aktiviteti

Tabelë 23 Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit

Tarifat e liçensimit të transportit të udhëtarëve		Njësia	Tarifa
1.	Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë / 10 vjet /linjë	80,000
2.	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/mjet/5vjet	5,000
3.	Liçensë për transport udhëtarësh në linjë te rregullt rrethqytetëse	Lekë/10 vjet/linjë	40,000
4.	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Lekë/mjet/5vjet	7,500
5.	Liçensë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vendit	Lekë/5 vjet	20,000
6.	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vendit	Lekë/5 vjet	7,500
7.	Liçensë për kryerjen e shërbimeve vajtje – ardhje (lavjerrës) të transportit të udhëtarëve brenda vendit	Lekë/5 vjet	20,000
8.	Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje - ardhje të transportit të udhëtarëve brenda vendit	Lekë/5 vjet	7,500
9	Çertifikatë për kryerjen e operacioneve të transportit për llogari të vet brenda vendit	Lekë/5 vjet	7,500
10.	Liçensë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	Lekë/5 vjet	15,000
11.	Liçensë për agjensi ndërkombëtare udhëtarësh	Lekë/5 vjet	40,000
12.	Liçensë për transport udhëtarësh me taksi brenda vendit	Lekë/5 vjet	20,000
Tarifat e Liçensimit të Transportit të mallrave			
1.	Liçensë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit	Lekë/5 vjet	40,000
2.	Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brënda vendit	Lekë/kapacitet	100x5
3.	Çertifikatë për transport mallrash për vehte brenda vendit	Lekë/kapacitet	100x5
4.	Tërheqës	Lekë/tërheqës/ 5 vjet	7,500

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës :

Struktura përgjegjëse për vlerësimin, planifikimin, përlllogaritjen dhe vjeljen e tarifës:

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore është përgjegjëse për:

- shqyrtimin e dokumentacionit të liçencimit,
- përcaktimin e detyrimit financiar sipas llojit të shërbimit,
- lëshimin e faturës tatimore në lidhje me detyrimin.

Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifat Vendore.

Tarifat për liçencim dhe certifikim paguhen në momentin e **parashtrimit të kërkesës dhe para lëshimit të liçencës apo certifikatës** përkatëse.

Tarifat me afat vlefshmërie shumëvjeçar (5 ose 10 vjet) paguhen në mënyrë të **plotë paraprakisht** për periudhën e vlefshmërisë.

a.4.	Personat të cilët mhajnë kafshë të shoqërimit/luksit, në banesa individuale apo bashkëpronësi, janë të detyruar të mos lejojnë që ato të kryejnë ndotje dhe shkaktojnë	Lekë	2.000 - 5.000	10.000 - 20.000

	zhurma, duke u bërë shqetësim për pjestarët e tjerë të komunitetit, duke cënuar gëzimin e qetë të pronës së tyre;			
a.5.	Mbajtja apo qarkullimi i kafshëve si: (kuaj, lopë, dhen, dhi, derra, etj), në mjedise publike në qendrat urbane, parqe, plazhe përgjatë vijës bregdetare, lulishte dhe në vende të pamiratuara për këtë qëllim nga organi përgjegjës publik;	Lekë	2.000 - 5.000	10.000 - 20.000
a.6.	Transportimi i kafshëve të paregjistruara/ endacake (qen dhe mace), nga njëri vend në tjetrin, pa lejen e organeve kompetente.	Lekë	2.000 - 5.000	10.000 - 20.000
a.7.	Keqtrajtimi i kafshëve	Lekë	5000-20,000	
7	Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e qetësisë publike dhe normave detyruese të bashkëjetesës, këto veprime;	Njësia	Vlera për Individët	Vlera për personat fizikë, juridikë ose privatë
a.	Shkaktimi i zhurmave shqetësuese në mjedise publike dhe private nga muzika në bar-kafe, restorante dhe/ose lokale të tjera shërbimi, jashtë orareve të përcaktuara nga lejet përkatëse dhe legjislacioni në fuqi;	Lekë	5.000 - 10.000	10.000 - 20.000
b.	Shkaktimi i zhurmave shqetësuese të çfarëdo lloji në ambjentet e përbashkëta të banimit;	Lekë	5.000 - 10.000	10.000 - 20.000
c.	Shkaktimi i zhurmave shqetësuese nga punimet/ndërtimet në mjedise publike e private, të kryera jashtë orareve të përcaktuara nga rregullat e fqinjësisë së mirë, apo pa miratimin e organit përgjegjës publik;	Lekë	5.000 - 10.000	10.000 - 20.000
ç.	Gjenerimi i zhurmave shqetësuese, në zonat e banuara, ose brenda apartamenteve, banesave etj., nëpërmjet: borive, megafonëve, altoparlantëve, muzikës së lartë, marmitave me zhurmë të lartë etj., jashtë normave të parashikuara në ligj;	Lekë	5.000 - 10.000	10.000 - 20.000
d.	Djegia e mbeturinave apo ndezja e zjarrit në zonat e banuara, përgjatë vijës bregdetare, lulishte apo parqeve në vende të	Lekë	5.000 - 10.000	10.000 - 20.000

	papërcaktuara për këtë qëllim dhe pa lejen e strukturës përgjegjëse;			
e.	Përdorimi i materialeve apo sendeve të ndryshme imituese, tymuese, rrezeve lazer etj., në ambjentet e hapura dhe të mbyllura Publike;	Lekë	5.000 - 10.000	10.000 - 20.000
f.	Kryerja e aktivitetit të hipizmit, në mjedise publike në qendrat urbane, parqe e lulishte dhe në vende të pamiratuara për këtë qëllim nga organi përgjegjës publik;	Lekë	5.000 - 10.000	10.000 - 20.000
g.	Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje parashikuar në aktet nënligjore të miratuar nga këshilli bashkiak ose kryetari i Bashkisë së Shkodrës.	Lekë	5.000 - 10.000	10.000 - 20.000

IV.3.3 Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa liçensë, autorizim apo leje përkatëse, mosrespektim i tabelave rrugore

Tabelë 44. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa liçensë, autorizim apo leje përkatëse

1	Zhvillimi i nktiviteteteve pa liçencë, autorizim, apo leje përkatëse në rastet si më poshtë;	Njësia	Vlera për Individët	Vlera për personat fizikë, juridikë ose privatë
1.1	Zënie hapësire publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
1.2	Veprimtari të ndryshme fitimprurëse ose promocionale që zhvillohen në hapësirat publike;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
a.	Rezervim ose zënie e parkingut pa leje nga bashkia	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
b.	Transport udhëtarësh 1+4 dhe 1+8 pa liçencë, apo jashtë destinacionit të përcaktuar nga autoriteti liçensues;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
c.	Lëvizje me mjete të tonazhit të lartë, pa liçencë;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
ç.	Hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit i mjeteve të tonazhit të lartë;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
d.	Lëvizja e automjeteve në linja ndërqytetase dhe rrethqytetase që nuk respektojnë dispozitat ligjore;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000

e.	Lëvizja me autokarro, motokarro për transport mallrash pa liçencë, autorizim apo leje përkatëse;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
f.	Mosrespektimi i orarit të përcaktuar për mjetet e liçencuara të transportit publik;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
g.	Zënie e hapësirës publike për ekspozim/tregtim të produkteve bujqësore/blegtorale nga fermerët.	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
h.	Mosrespektim i tabelave të qarkullimit rrugor, dhe tabelave të tjera kufizuese të vendosura nga organet kompetente	Lekë	5.000 - 20.000	
i.	Shitje e lëndëve djegëse pa liçensë, për përdorim nga konsumatorët fundorë	Lekë	15.000 lekë	
j.	Shkelje e kritereve dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin Nr. 15, datë 03.03.2025, "Për miratimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e agjencive funerale / shtëpi funerale (salla pritje), në territorin e Bashkisë Shkodër (VKB nr. 81 datë 18.12.2025)	Lekë	20.000 lekë	

IV.3.4 Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor

Tabelë 45. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor

2	Ndërhyrje në rrjetin elektrik dhe telefonik rrugor si;	Njësia	Vlera për Individët	Vlera për personat fizikë, juridikë ose privatë
a.	Lidhjet e pamiratuara në shtyllat e ndriçimit, tabela, pemë, rrjetin ajror, etj.	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
b.	Dëmtim i shtyllave ndriçuese ose ndriçuesve të ndriçimit publik	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
c.	Përdorimi i shtyllave të gjitha llojeve si suport mbajtës/mbështetës për montimin e reklamave, kapjen e kabllave elektrike, telefonike, të internetit etj;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
ç.	Dëmtimi i traseve kabllore dhe/ose linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me ose pa leje, si dhe shkuljen e shtyllave;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
d.	Ndërhyrja apo dëmtimi në kuadrot elektrike publike.	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000

IV.3.5 Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve

Tabelë 46. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit

3	Ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit;	Njësia	Vlera për Individët	Vlera për personat fizikë, juridikë ose privatë
a.	Lidhjet e pamiratuara në tubacionet shkarkuese ose të ujitjes;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
b.	Dëmtim i pusetave;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
c.	Dëmtim i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre, me ose pa leje.	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000

IV.3.6 Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbërta dhe publike

Tabelë 47. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbërta

4	Ndërhyrjet në hapësirat publike dhe të gjelbërta, si;	Njësia	Vlera për Individët	Vlera për personat fizikë, juridikë ose privatë
a.	Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
b.	Dëmtimi ose prerja e pemëve në hapësira publike;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
c.	Vendosje posterash reklamuese pa leje, në fasada, pemë, shtyllë, tabela, pankarta, banderola;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
ç.	Zënie e hapësirës së gjelbërt pa leje;	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000
d.	Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet nënligjore/normative të miratuara nga këshilli bashkiak ose kryetari i Bashkisë Shkodër.	Lekë	5.000 - 15.000	10.000 - 20.000

IV.3.7 Niveli i gjobave për kundravajtjet në normat e sjelljes

Tabelë 48. Niveli i gjobave për kundravajtjet në normat e sjelljes

1	Për aq sa nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative në fushën e normave të sjelljes, këto veprime;	Njësia	Vlera për Individët
a.	Dalja zhveshur ose pjesërisht të zhveshur (duke ekspozuar pjesët intime) në mjediset publike;	Lekë	2.000 - 5.000

b.	Urinimi, defekimi apo pështyrja në mjedise publike;	Lekë	2.000 - 5.000
c.	Të bërtiturit me fjalë apo shprehje të pahijshme, gjeste vulgare në mjediset publike;	Lekë	2.000 - 5.000
ç.	Veprimet apo sjelljet e çdo natyre që kanë për qëllim ngacmimin, fyerjen apo talljen ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara, të moshuarve, të miturve, etj;	Lekë	2.000 - 5.000
d.	Dehja në mjedise publike apo private, kur shoqërohet me veprime që krijojnë shqetësim për qytetarët, kryesisht ose me ankimin nga qytetarët dhe pengojnë aktivitetin normal të tyre;	Lekë	2.000 - 5.000
e.	Kërkimi i lëmshës në mjedise publike dhe fshirja ose pastrimi i xhamave të makinave në semafor;	Lekë	2.000 - 5.000
f.	Si edhe çdo veprim apo mosveprim tjetër i cilësuar si kundërvajtje administrative, parashikuar në aktet nënligjore/normative të miratuara nga këshilli bashkiak ose kryetari i Bashkisë Shkodër.	Lekë	2.000 - 5.000
g.	Veprime të turpshme në ambjente publike	Lekë	5.000 - 20,000
2.	Subjektet që ushtrojnë, veprimtarinë e tyre si klube të natës/disko (striptizëm) të cilat janë hurim i ndotjes akustike dhe pamore për banorët dhe qytetin dhe/ose zonat turistike, janë të detyruara të kryejnë aktivitetin e tyre jashtë perimetrit të caktuar nga organi ekzekutiv i Bashkisë Shkodër.	Lekë	2.000 - 5.000

IV.3.8 Niveli i gjobave për kundravajtje të tjera

Tabelë 49. Niveli i gjobës për përdorimin e pa autorizuar të logos së Bashkisë së Shkodrës dhe mosrespektim i akteve, vendimeve administrative të dala nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë

3.8.	Niveli i gjobave për kundravajtje të tjera :	Njësia	Vlera
1	Përdorimin e pa autorizuar të logos së Bashkisë	Lekë	20,000
2	Mosrespektim i akteve, vendimeve administrative të dala nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë	Lekë	20,000

Në rastet e zhvendosjes së automjeteve me karrotrec për shkak të shkeljeve të rregullave të qarkullimit apo parkimit të gabuar, aplikohen tarifa si me poshte

- Sherbim i transportit te mjeteve te bllokuara me karrotrec

Motoçikleta dhe ciklomotorë	5000 leke
-----------------------------	-----------

- Sherbim i transportit te mjeteve te bllokuara me karrotrec
Për automjete 10,000 leke

Referuar rregullores "PËR CAKTIMIN E DISA KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSËT PËR TO NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË SHKODER" - neni 26

1. Gjohat paguhen vullnetarisht brenda 10 ditëve; pas kalimit të afatit të parashikuar, zbatohet një kamatëvonesë prej 2% (dy përqind) mbi masën e gjobës, për çdo ditë vonesë. Shurna totale e kamatëvonesave nuk mund të tejkalojë masën e gjobës.

2. Në rast të pagesës së gjobës brenda 5 (pesë) ditëve në mënyrë vullnetare, kundravajtësi përfiton 30% (tridhjetë për qind) zbritje të vlerës së gjobës.

Gjohat do të paguhen pranë bankave të nivelit të dytë, apo pranë Filialit Posta Shqiptare sh.a. Shkodër ose ente të tjera të ligjshme.

Gjohat e Policisë Bashkiake për kundravajtjet rrugore, vendosen bëhen sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor.

Masa Plotësuese: Bllokimi dhe Ruajtja e Mjetit

Përveç gjobës, paguhen edhe shpenzimet ditore të parkimit/ruajtjes së mjetit të bllokuar në ambientet përkatëse, të cilat parashikohen si më poshtë;

Tarifa për qëndrim të automjeteve në pikën e bllokimit të Policisë Bashkiake

Lloji i Mjetit	Tarifa Ditore e Parkimit
Motoçikleta dhe ciklomotorë	500 lekë/ditë
Automjete (vetura 4+1, 6+1)	2,000 lekë/ditë
Automjete (vetura 8+1)	2,500 lekë/ditë
Mjete me tonazh të lartë	3,000 lekë/ditë

Zbatimi i këtyre penaliteteve i ngarkohet Policisë Bashkiake, e cila regjistron gjohat në sistemin informatik të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Shkodër dhe ndjek deri në fund, nga ana ligjore arkëtimin e tyre.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore llogarit kamatëvonesat e gjobave.

Për çdo rast dëmtimi të aseteve publike, krahas masës administrative, subjektet janë të detyruara që të kthejnë ambientin në gjendjen e mëparshme, ose të zhdëmtojnë vlerën e dëmit të shkaktuar sipas vlerësimit nga institucioni përgjegjës.

Përjashtohen nga pagimi i gjobave vetëm rastet përjashtimore të parashikuara në Ligjin Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative.

³⁷ Shfuqizuar me Ligjin 71/2020

Tabelë 50 Niveli i gjobave (kundërvajtjeve administrative) në fondin pyjor kombëtar

IV.3.9	³⁸ Niveli i gjobave (kundërvajtjeve administrative) në fondin pyjor kombëtar	Njësia	Tarifa
1	Dënohen me gjobë nga 5 000 deri në 10 000 lekë shkeljet e mëposhtme; a) nxjerrja dhe grumbullimi i prodhimeve drusore dhe jodrusore nga individë të paformalizuar dhe pa lejen përkatëse;	Lekë	5,000-10,000

- b) prerja pa damkë e drurëve dhe prerja pa leje e pyjeve, drurëve të veçuar dhe e shkurreve, filizërisë dhe e fidanëve në fidanishte, kur pasojat materiale janë të lehta;
- c) mbledhja e prodhimeve jodrusore nga pylli jashtë periudhës teknike të vjeljes, si dhe nxjerrja e rrënjëve të drurëve pyjorë gjatë periudhës së vegjetacionit;
- d) kullotja e bagëtive në fondin pyjor kombëtar të përfshirë në zonat e mbrojtura, në pyllëzimet e reja dhe në sipërfaqet me pyje të ulëta të ricunguara, në grumbujt pyjorë, që kanë arritur moshën e pjekurisë, në të cilët pritet që të arrihet ripërtëritja natyrale, në pyjet e shfrytëzuara ose në shfrytëzim e sipër deri sa të jetë bërë ripërtëritja natyrale e tyre, në pyjet e reja, në filizëri, në fidanishte, në ngastrat gjenetike e eksperimentale, në sipërfaqet ku kryhen punime përmirësuese dhe në pyjet mbrojtës;
- e) krasitja për gjethe, kositja dhe grumbullimi i barit në fondin pyjor kombëtar pa lejen përkatëse;
- f) parkimi i automjeteve, vendosja e rulotëve në pyjet me funksion mbrojtës e të veçantë, në parqet kombëtare, në rezervatet e mbarështimit të florës e të faunës së egër, në fidanishtet pyjore ose në vendet e tjera të fondit pyjor kombëtar, me rëndësi të veçantë, pa lejen përkatëse;
- g) nxjerrja e gurëve, plisave, rrënjëve, cungjeve, marrja e dheut, rërës dhe zhavorrit, kur pasojat materiale janë të lehta, pa lejen përkatëse;
- h) mosruajtja e materialit drusor dhe e çdo prodhimi tjetër, me origjinë pyjore, të sekuestruar, i cili ndodhet në qendrat e përpunimit apo në sheshet e depozitimit e të tregtimit, nga subjektet të cilave u është sekuestruar, deri në shitjen e tyre.

³⁸ Ligji 57/2020

2.	Dënohen me gjobë nga 20 000 deri në 40 000 lekë shkeljet e mëposhtme;	Lekë	20,000 - 40.000
	a) ndërhyrjet për pyllëzime dhe përmirësimin e bimësisë së tokave pyjore pa lejen përkatëse dhe në kundërshtim me rregullat për pyllëzimet, përfshirë pyllëzimin me farë në terrenet e zhveshura, si dhe përdorimi i plehrave kimike apo pesticideve pa lejen përkatëse dhe në kundërshtim me rregullat;		

	<p>b) grumbullimi, shpërndarja ose mbjellja e farave, kalemave, shpatullave e fidanëve pyjorë të drurëve e shkurreve pyjore pa lejen e agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet, mbjellja e farave dhe e materialit tjetër vegetativ pyjor, të papajisur me certifikatën përkatëse, si dhe 31 shitja apo shpërndarja nga fidanishtet, që merren me aktivitetin prodhues të materialit vegetativ mbjellës dhe farërave, të pashoqëruar me certifikatën e origjinës dhe atë fitosanitare;</p>		
	<p>c) prishja, fshirja ose dëmtimi i shenjave kufidëftuese, gjeodezike e topografike i tabelave paralajmëruese apo treguese, të vendosura në fondin pyjor kombëtar;</p>		
	<p>ç) prerja pa leje apo dëmtimi i pyjeve, në pronësi private, nga pronarët apo nga subjektet, të cilave u janë dhënë në përdorim ose me qira, kur pasojat materiale janë të lehta.</p>		
3	Dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë shkeljet e mëposhtme;	Lekë	50,000 - 100,000
	<p>a) ngritja e strukturave, punimeve, zhvillimeve të ndryshme dhe kryerja e veprimtarive në fondin pyjor kombëtar pa lejen përkatëse;</p>		
	<p>b) ndezja e zjarreve jashtë vendeve të caktuara apo në fondin pyjor kombëtar, publik dhe privat, në tokat e tjera në afërsi të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që përbën burim ose shkak për përhapjen e pakontrolluar të tyre;</p>		
	<p>c) prishja e shenjës së damkës në dru apo përdorimi i çekiçdamkës nga persona të paautorizuar dhe nga një zonë pyjore në tjetrën;</p>		
	<p>d) ndryshimi i zërit kadastral në kundërshtim me procedurat ligjore në fuqi dhe mosraportimi i ndryshimeve përkatëse në fondin pyjor kombëtar dhe në tokën pyjore, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe pronarin privat;</p>		
	<p>e) shndërrimi i pyjeve të larta në cungishte, prerja rrah e pyjeve të larta (me përjashtim të ndërhyrjeve të nevojshme për mbrojtjen fitosanitare ose për arsye të tjera me interes publik), si dhe shfrytëzimi i pyjeve</p>		

	cungishte dhe prerja rrah në periudhën e vegjetacionit, si dhe kur nuk sigurohet mbrojtja hidrogeologjike e territorit, ruajtja e burimeve ujore, mbrojtja e peizazhit dhe mjedisit, turizmi dhe rekreacioni;		
	f) prerja rrah në pyjet me funksion mbrojtës, si dhe prerjet e pyjeve në kufijtë e sipërm të vegjetacionit pyjor, mbi dhe nën rrugët kombëtare deri 150 metër linear, përreth qendrave të banuara dhe objekteve të rëndësishme, përgjatë rrjedhave ujore.		
4	Dënohen me gjobë nga 80 000 deri në 100 000 lekë shkeljet e mëposhtme:	Lekë	80,000 - 100,000
	a) transferimi i të drejtave të siguruara nga kontrata e trajtimit, shfrytëzimit dhe përdorimit në fondin pyjor kombëtar;		
	b) tregtimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera të pyllit, të infektuara nga sëmundjet, barërat e këqija e parazitare ose të prekura nga insektet;		
	c) mbledhja e prodhimeve jodrusore nga pylli, me mënyra që sjellin degradimin, kërcënimin, rrallimin, zhdukjen apo dobësimin e funksioneve të tyre;		
	d) kryerja e veprimtarive pa lejen përkatëse kur kryhet në fondin pyjor kombëtar, të deklaruar me funksion mbrojtës e të veçantë (si ngritja e ndërtimeve të thjeshta, gardhimeve, kampingjeve, ndërhyrjet me punime në dunat bregdetare, pjesë e fondit pyjor kombëtar etj);		
	e) përdorimi i paligjshëm i fondit pyjor kombëtar dhe i tokës pyjore.		
5	Dënohen me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë shkeljet e mëposhtme;	Lekë	100,000 - 300,000
	a) eksporti i lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, druve të zjarrit dhe asortimenteve që rrjedhin nga tjetërsimi i tyre, si edhe qymyrit të drurit, apo të tjera produkte, gjithmonë kur këto ndalohen specifikisht të eksportohen me ligj apo vendim të Këshillit të Ministrave;		
	b) ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i veprimtarive, që shkaktojnë degradimin dhe gërryerjen e tokës (si: ndërtimi i furrave të gëlqeres dhe i kaminave të		

	qymyrit të drurit, dëmtimi i infrastrukturës pyjore, si rrugë dhe vepra ujore në fondin pyjor kombëtar;		
	c) mosripyllëzimi i sipërfaqeve ose i brezave pyjorë pas prerjeve rrah të llojeve që nuk ripërtërihen në rrugë natyrore, si dhe mos pyllëzimi/ ripyllëzimi nga ana e personave fizikë/juridikë për sipërfaqe që hiqen nga fondi pyjor kombëtar;		
	d) hedhja e mbetjeve brenda sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar dhe jashtë vendeve të caktuara, kur pasojat materiale janë të lehta.		
6	Dënohen me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë shkeljet e mëposhtme;	Lekë	300,000-500,000
	a) transporti me automjete apo mjete të tjera i materialit drusor nga pylli dhe prej shesheve të depozitimit për në qendrat e përpunimit e të shitjes, si dhe i produkteve jodrusore pyjore drejt qendrave të grumbullimit, i pashoqëruar me dokumentacionin që provon origjinën e tij;		
	b) mosrealizimi i masave apo punimeve të parashikuara në projekte në mjedisin pyjor, si dhe mospastrimi i parcelës së shfrytëzuar.		
7	Dënohen me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë shkeljet e mëposhtme;		500,000-1,000,000
	a) shkarkimet e kimikateve, të ujërave të ndotura industriale në fondin pyjor kombëtar;		
	b) gjurmimi për karriera të çdo lloji që përdorin lëndë plasëse pa lejen përkatëse;		
	c) djegia e sipërfaqeve në fondin pyjor kombëtar, me qëllim ndryshimin e destinacionit të tyre, ndryshimin e destinacionit të sipërfaqeve të djegura në fondin pyjor kombëtar, si dhe kur cenon ruajtjen e biodiversitetit, stabilitetin e terrenit, regjimin e ujit, mbrojtjen nga rënia e gurëve dhe ortekëve, ruajtjen e peizazhit, si dhe rolin e pyjeve për mbrojtjen nga era.		
8	Kur pasojat janë të rënda, për shkeljet e cituara më poshtë, dënimi me gjobë është si vijon;	Lekë	
	a) prerja pa damkë e drurëve dhe prerja pa leje e pyjeve, drurëve të veçuar dhe e shkurreve, filizërisë dhe e fidanëve në fidanishte, kur pasojat janë të rënda, dënohet me gjobë		500,000-1,000,000

b) nxjerrja e gurëve, plisave, rrënjëve, cungjeve, marrja e dheut, rërës dhe zhavorrit, kur pasojat janë të rënda, pa lejen përkatëse, dënohet me gjobë	100,000-300,000
c) hedhja e mbetjeve brenda sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar dhe jashtë vendeve të caktuara, kur pasojat janë të rënda, dënohet me gjobë	500,000-1,000,000

Kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Kur shkeljet e këtij ligji kanë sjellë pasoja të rënda, struktura përkatëse bën kallëzim penal.

Tabelë 51 ³⁹Niveli i gjobave (kundravajtjet administrative) nga inspektoriat në Bashkinë Shkodër

IV.3.10	Niveli i gjobave për kundravajtjet administrative nga inspektoriat në Bashkinë Shkodër;	Njësia	Vlera
1.	Moskryerja e takimit publik dhe këshillimit;	Lekë	50.000 - 100.000
2.	Shkelja e afateve të botimit në regjistër të akteve dhe projekt-akteve, për të cilat botimi është i detyrueshëm;	Lekë	50.000 - 100.000
3.	Miratimi i lejes së ndërtimit dhe lëshimi i çertifikatës së përdorimit, në kundërshtim me këtë ligj ose me dokumentet e planifikimit në fuqi;	Lekë	1.000.000 - 3.000.000
4.	Mosveprimet e pambështetura në ligj, me pasojë miratimin në heshtje, në kundërshtim me ligjin;	Lekë	1.000.000 - 5.000.000
5.	Mosrespektimi i afatit të dorëzimit të lejes së ndërtimit;	Lekë	300.000 - 500.000
6.	Mosdeklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje;	Lekë	50.000 - 150.000
7.	Shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve;	Lekë	100.000 - 500.000
8.	- kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, sipas preventivit përkatës të depozituar pranë autoriteteve përgjegjëse, por, në çdo rast, jo më ii. pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror, kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me: i. konfiskim për interes publik apo strehim social të punimeve të kryera pa leje kur ndërtimi pa leje është mbi masën 2% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi dhe nën tokë; ii. prishje apo konfiskim për interes publik, për të gjithë objektin, kur ndërtesa është e qëndrueshme, në	Lekë/ m ²	< 35.000

	<p>rastet kur:- ndërtimi rezulton pa leje, mbi dhe nën tokë;- ndërtimi pa leje tejkalon masën 10% të sipërfaqes totale ndërtimore mbi dhe nën tokë</p> <p>-</p>		
	<p>- Kryerja e punimeve pa leje brenda brezit bregdetar, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në zonat e mbrojtura apo në zonën kufizuese të një monumenti kulture, krahas dënimit, sipas shkronjës “e” të kësaj pike, dënohet edhe me gjobë në masën 10% të vlerës së preventivit. Për objektet e ndërtuara tërësisht pa leje brenda brezit bregdetar në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në zonat e mbrojtura apo në zonën kufizuese të një monumenti kulture, krahas dënimit, , dënohet edhe me gjobë në masën 10% të vlerës së shitjes për metër katror.</p>	Lekë	10% + preventiv
	<p>- Lejet apo deklaratat paraprake të punimit, të miratuara në këto zona nga organet e pushtetit vendor, pa marrë paraprakisht aktin e konformitetit nga Sekretariati Teknik i KKTU-së, janë akte absolutisht të pavlefshme.</p>	Lekë	2.000.000
9.	<p>Kryerja e ndryshimeve në projekt apo e punimeve në shkelje të kushteve të lejes, pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje;</p>	Lekë	< 300.000
10.	<p>Përdorimi i objektit pa lëshimin e çertifikatës së përdorimit;</p>	Lekë	300.000 - 500.000
11.	<p>Vazhdimi i punimeve me gjithë vendimin administrativ për pezullimin ose ndërprerjen;</p>	Lekë	10.000 - 20.000
12.	<p>Hartimi i projektit të ndërtimit, kryerja e oponencës, mbikqyrjes, zbatimit të punimeve dhe kolaudimit të objektit në kundërshtim me ligjin, dokumentet e planifikimit ose me lejen e ndërtimit, pavarësisht nëse përbën vepër penale, përbën kundravajtje administrative.</p>	Lekë	1.000.000 – 3.000.000

Vlera e punimeve të kryera pa leje, sipas pikës 1, shkronjat “e” dhe “ë” sipas ligjit 107 date 31.7.20214 Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit i ndryshuar, të nenit 52, llogaritet sipas koston mesatare të ndërtimit, të përcaktuar me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

Në rastin e konstatimit të ndryshimeve në projekt apo shkeljeve të kushteve të lejes, pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor dhe volume shtesë, autoriteti i inspektimit, krahas dënimit sipas nënndarjes "i", te shkronjës "e", të këtij neni, pezullon punimet dhe i cakton

një afat deri në 45 ditë (dyset e pesë ditë) subjektit për të aplikuar për pajisjen me leje të punimeve të kryera në ndryshim të projektit dhe lejes së miratuar pranë autoritetit vendor dhe njofton autoritetin e planifikimit. Aplikimi për pajisjen me leje shoqërohet nga dokumentacioni tekniko-ligjor, argumentimi teknik për ndryshimet në projekt apo për mosrespektimin e kushteve të lejes dhe vërtetimi i pagesës së gjobës. Në rast se subjekti nuk aplikon brenda afatit, autoriteti i planifikimit merr vendim, sipas pikës 4 të këtij neni, në lidhje me ndërtimin.

Autoriteti i planifikimit shqyrton kërkesën e paraqitur, sipas pikës 3, të këtij neni, dhe mund të miratojë lejen për ndryshimet në projekt apo punimet jashtë kushteve 32 të lejes, vetëm në rast se ndërtimi nuk është në kundërshtim me dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit, dhe nuk cënon të drejtat pronësore të personave të tjerë, si dhe qëndrueshmërinë e sigurinë e objektit. Në rastet kur ndërtimi është në perputhje me kërkesat e mësipërme, autoriteti i planifikimit merr vendim për miratimin e kërkesës dhe pajisjen me leje. Në rast të kundërt, autoriteti përgjegjës vendos prishjen e ndryshimeve apo punimeve jashtë kushteve të lejes.

³⁹ Ligji 119/2020

Kur prishja nuk mund të kryhet pa cënuar pjesën e ndërtimit në konformitet me projektin dhe lejen e miratuar, autoriteti i planifikimit vendos një gjobë të barabartë me dyfishin e vlerës së punimeve të kryera në shkelje të lejes, por në çdo rast jo më pak se 1 000 000 lekë. Pas pagesës së gjobës, autoriteti përgjegjës miraton lejen e ndërtimit për punimet përkatëse.

Tabelë 51 Niveli i gjobave (kundravajtjet administrative) nga inspektorati në Bashkinë Shkodër

IV.3.11 ⁴⁰	Niveli i gjobave për kundravajtjet administrative nga inspektorati në Bashkinë Shkodër	Njësia	Vlera
1.	Shkeljet e neneve 4, 5, 6, 7 e 8 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative;	Lekë	50.000 – 2.000.000
2.	Shkeljet e neneve 9, 10 e 11 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative;	Lekë	50.000 - 100.000
3.	Shkeljet e neneve 12 e 14 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative;	Lekë	500.000 - 5.000.000

Gjobat vendosen nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë / Qarkut, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin.

Për moszbatimin e detyrimeve, të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, përveç dënimit kryesor me gjobë, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Bashkisë/Qarkut u paraqet organeve përkatëse kërkesën për heqjen e liçencës së mbikëqyrësit të punimeve.

Neni 15 /a - (shtuar me ligjin nr.9794, datë 23.7.2007, shpallur i papajtuësëm me Kushtetutën, me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.23, datë 8.6.2011)

Kryerja e punimeve të ndërtimit pa leje ndërtimi, me pasojë krijimin e sipërfaqeve ndërtimore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Kryerja e punimeve të ndërtimit, me pasojë shtesa në sipërfaqe ndërtimore, tej lejes së ndërtimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Sipërfaqet e realizuara nga kryerja e punimeve të ndërtimit, në shkelje të dispozitave të këtij neni, kur nuk prishen, konfiskohen në favor të shtetit.

Neni 16 - Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 diteve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2% (dy për qind) për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

⁴⁰ Sipas Ligjit 120/2020

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë llogarit kamatëvonesat e gjobave.

IV.3.12. Në lidhje me përgjegjësitë e drejtorive që planifikojnë dhe krijojnë të ardhura;

- Nisur nga një shqyrtim i VKB Nr.1, datë. 22.01.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar (Paketa Fiskale) dhe analizës së zërave të ardhurave, propozojmë që, **çdo drejtori apo institucion varësie që planifikon të ardhura, të jetë përgjegjës përveç planifikimit dhe për ndjekjen, faturimin dhe arkëtimin e tyre.**

Kjo procedurë është e domosdoshme sepse:

1. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e planifikuara nga drejtoritë apo institucionet e varësisë së bashkisë, janë të ardhura të cilat nuk duhet të krijojnë detyrime të prapambetura (debitorë).
2. Janë të ardhura të cilat mblidhen përmes parapagimit (pra janë me parapagim), pasi shërbimi nuk ofrohet nëse nuk bëhet pagesa. Fatura e pagesës, tërhiqet pranë ZIN-së.
3. Çdo drejtori, mban përgjegjësi për realizimin ose jo të të ardhurave të veta të planifikuara. Për sa më sipër, është e rëndësishme që në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër, evidentohet fakti, ku përcaktohet që drejtorja/institucioni i varësisë, i cili bën planifikimin dhe ofron shërbimin, të jetë dhe struktura përgjegjëse e vjeljes së detyrimit.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës është Drejtoria (emri i drejtorisë që bën planifikimin dhe ofron shërbimin) pranë Bashkisë Shkodër.

Kapitulli V Të ardhura jo tatimore

V.1. Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë

Sipas përcaktimeve ligjore pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën-ndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

Të ardhurat nga qiratë paguhet nga përfituesi dhe shfrytëzuesi i pronës në pronësi të bashkisë, bazuar në kontratën e lidhur mes palëve.

Drejtoria Juridike, Njësia e Prokurimit dhe sektori i Aseteve kryejnë procedurën e plotë të dhënies me qira deri në hartimin e kontratës dhe kërkojnë lëshimin e faturës nga ana e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore. Ndjekja e zbatimit të kontratës kryhet nga Sektori i Aseteve.

V.2. Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime

Bazuar në Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" si dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", të ndryshuar, të gjitha njësitë e sektorit publik kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Nëpunësit Autorizues të të gjithë niveleve të njësisë publike kanë detyrimin që të kryejnë të gjitha analizat deri në vlerësimin për ngarkim të shkaktarëve që lejojnë veprime abuzive në trajtimin e aktiveve.

V.3. Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve

Sipas përcaktimeve ligjore janë të ardhura që përfshihen në zërin të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve. Aktivitet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

V.4. Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

Sipas përcaktimeve në ligjin "Për vetëqeverisjen vendore", akteve normative dhe procedurave ligjore, Bashkitë krijojnë të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

V.5. Të ardhura nga privatizimi

Baza ligjore për të ardhurat nga privatizimi: VKM nr. 97, datë 3.2.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave objekt i ligjit 7652, datë 23. 12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe ligjit 9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet të shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore dhe VKB nr. 153 dt.11.12.2012 "Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave".

Të ardhurat nga privatizimi paguhet nga përfituesi i pronës. Drejtoria Juridike ose komisioni përgjegjës përcjell dokumentacionin e përpunuar për lëshimin e faturës te Drejtoria përgjegjëse për Taksat dhe Tarifat Vendore, që lëshon faturën për arkëtim.

V.6. Të ardhura nga komisioni si agjent tatimor.

Baza ligjore për të ardhurat nga komisioni si agjent tatimor për mbledhjen e Takseve se akteve dhe e pullës: neni 5 i ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar.

Sipas nenit 8, germa "ç", të këtij ligji, taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 5, shtojca nr. 3, të këtij ligji, dhe transferohen në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore dhe të llogarive të njësisë të qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj. Agjentët e taksave, për shërbimin që kryejnë, përfitojnë komision, të cilin e marrin në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje mbi shumën e arkëtuara të taksave që kanë transferuar në llogari të drejtorisë rajonale tatimore dhe në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore. Masa e komisionit për taksën e akteve dhe të pullës është 5 për qind;

V.7. Të tjera.

Tarifat vjetore për subjektet llogariten dhe faturohen për çdo njësi referuar çdo vendi të ushtrimit të aktivitetit sipas Regjistrimit Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe llojit e vendndodhjes së aktivitetit për çdo rast.

Për njësitë “Kompleks shërbimesh” (Njësi me një adresë në QKB, por me më shumë se një aktivitet në këtë adresë, sipas verifikimit në terren, psh: tregtim karburant, bar, hotel, restorant, etj), do të faturohen veçmas për secilin aktivitet për tarifën vendore vjetore.

Për tarifimin e subjekteve të ndërtimit, merret për bazë adresa kryesore sipas QKB-së (selia administrative). Përveç këtyre rasteve, kur adresa kryesore është në juridiksion të Bashkisë Shkodër, përjashtohen nga tarifën vjetore (pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj) të gjithë vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit, sipas QKB-së (adresa sekondare, kantieri ndërtimi), dhe detyrimi i tarifës së pastrimit për punimet që kryhen, është shlyer në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit ose deklaratës paraprake të punimeve nga investitori. Nuk përjashtohen nga detyrimet tarifore vjetore zyrtarët e shitjes, ekspozimit, kontabilitetit, financës etj, që ushtrojnë aktivitet dhe ndodhen në ambientet e kantierëve të ndërtimit, por trajtohen referuar paketës fiskale.

Për automjetet që janë në funksion të subjekteve që nuk kanë aktivitet transport malli/udhëtari për vete ose për të tretë, nuk llogariten tarifa vjetore për çdo targë automjeti, të pasqyruar si adresë sekondare, në ekstraktin historik të QKB-së.

Detyrimet për taksat dhe tarifën vendore për bizneset që regjistrohen ose çregjistrohen përgjatë vitit, do të llogariten në përpjestim si muaj të plotë për çdo muaj që ka ushtruar aktivitet, edhe nëse aktiviteti nuk është kryer për gjithë muajin.

Profesionet e lira do të quhen subjektet, bazuar në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, personat e tatueshëm, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë. Nëse subjekti është biznes me xhiro mbi 8 milion lekë brenda një viti fiskal, ai do të trajtohet me taksat dhe tarifën, si njësitë e tregtisë dhe shërbimit.

Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore, drejtuar tatimpaguesit dhe çdo korrespondencë tjetër që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore, konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik dhe të postës rekomandë. Data e njoftimit është data e nisjes së mesazhit elektronik apo e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar. Llogaritja e afatit fillon nga e nesërmeja e datës kur akti është marrë ose konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi. Tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë adresën e saktë, në mënyrë që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve. (Neni 23 i Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH.” i ndryshuar.

Njoftimet elektronike të administratës tatimore vendore, të dërguara përmes shërbimeve zyrtare të portalit qendror **e-Albania**, kanë të njëjtën fuqi ligjore si njoftimet e bëra me postë të regjistruar ose me dorë. Tatimpaguesi është i detyruar të mbajë aktive llogarinë e tij në portalin e-Albania dhe të deklarojë të dhëna të sakta të kontaktit (adresë elektronike, numër telefoni dhe çdo të dhënë

tjetër të kërkuar nga sistemi), me qëllim sigurimin e marrjes së njoftimeve në kohë. Mospërditësimi i të dhënave të kontaktit, mosaksesimi i rregullt i llogarisë së e-Albania ose pamundësia e marrjes së njoftimit për shkak të mosveprimit nga tatimpaguesi **nuk përbën shkak pezullimi të afateve** dhe nuk ndikon në vlefshmërinë ligjore të njoftimit.

Ankimi i taksapaguesit në nivel vendor, kundër vendimit apo veprimit të zyrës së taksave, bëhet te struktura vendore e apelimit tatimor, pas ankimit administrativ, sipas kritereve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak, me VKB Nr. 56, Datë. 19.07.2018 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të apelimit tatimor në Bashkinë Shkodër".